

PËRRALLA TË ZGJEDHURA

3982

P61.



398

P61

Redaktor
Boris Omeri

Përralla të zgjedhura

I zgjedhi dhe i përktheu

DHIMITËR PASKO



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktore
Donika Omari

Botim i dytë

Recensues

Dalan Shaplo

SHIPTARIA BOTUESE "NAIM FRASHERI"

Parathënie

Përralla është krijimtaria më e lashtë dhe më e dashur e popujve. Më e lashtë, por gjithnjë e re, e freskët, tërheqëse. Atë nuk e vjetërojnë as shekujt as mijëvjeçarët. Ne të gjithë e thithim, të magjepsur, në vegjëli, që në djep ose sapo të ngritur nga djepi, e dëgjojmë me ëndje të madhe në mituri e në të ri dhe e shijojmë rishtas e rishtas, me mall, në moshë të thyer dhe në pleqëri. Ajo hap para nesh botën e mrekullimadhe të fantazisë dhe të ëndërritjes së popujve për një jetë të lumtur, na jep thesarin e mënçurisë njerëzore, na çfaq e na përshkruan luftën e pareshtur të së mirës e

të së drejtës kundër së keqes e së shtrembërës, kundër shtypjes e shfrytëzimit, kundër varfërisë e gënjeshtres dhe sa e sa mynxyrave të tjera, nga të cilat ka vuajtur njerëzimi gjatë mijra vjetëve, që kur ka zënë fill jeta.

Cili nga ne nuk gëzohet, duke ndjekur me zemër në dorë vuajtjet dhe bëmët e heroit ose të heroinës së dashur, kur dëgjon se, fundi i fundit, këta dalin faqebardhë dhe fitimtarë nga provat dhe vështirësitë e shumta? Cili nga ne nuk ka adhuruar dhe nuk adhuron shkathtësinë e mëndjes së heronjve, fuqinë e tyre, bukurinë dhe bujarinë e shpirtit? Cili nga ne nuk gëzohet kur zana, plaku ose plaka zemërmirë i ndihmojnë dhe i shpëtojnë këta heronj kur gjenden në ngushticë të madhe, për të mposhtur të keqen dhe gjëmën? Cili nga ne nuk ka urryer dhe nuk urren mbretërit shtypës e dhunëtarët e tjerë, përbindëshit dhe shtrigat, shtypësit e të gjitha kallëpeve, mashtronjësit, përtacët, njerëzit zemërgurë, që mundojnë dhe shfrytëzojnë botën? Të gjithë, të gjithë.

Autori i përrallës është shkrimtari më i madh dhe më i talentuar i gjithë kohëve, populli, që i jep asaj brendinë e lartë morale dhe thelbin e drejtë shoqëror në një trajtë të bukur, sa më të thjeshtë dhe sa

më tërheqëse, në një gjuhë të rrjedhshme, e cila ruan dhe shpie më tej, brez pas brezi, thesarët më të çmuar gjuhësorë.

Siç thamë, përralla është një ngjizje shumë e mocme. Por duhet të shtojmë se kjo ngjizje nuk është e shtangët, e ngurosur përgjithmonë nga përmbajtja dhe veshja e saj apo trajta. Gjatë kohës, ajo ndryshohet bashkë me ndryshimin e kushteve të jetës, të mjeteve të punës dhe të luftës, të mjeteve të prodhimit dhe rrethave shoqërore.

Përralla ndryshohet dhe përtërihet gjithnjë, duke ndjekur, në një farë mënyre, hapin e kohës.

Kështu, përralla udhëton nga një shekull tek tjetri, nga një popull tek tjetri, duke kaluar gojë më gojë. As largësia gjeografike, as gjuha nuk janë pengesa të pakapërcyeshme, sepse njerëzit e kombeve të ndryshme shtegtojnë nga një vend tek tjetri, bëjnë lidhje njëri me tjetrin, shpien e sjellin prodhimet e punës së tyre dhe i shkëmbejnë këto me prodhimet e të tjerëve. Po ashtu, në këto shtegtime ata shpien e sjellin edhe krijimtarinë e tyre gojore, sidomos përrallën, bëhen bartës dhe përhapës të kulturës së tyre dhe të kulturave të huaja.

Veç asaj që thamë më lart, duhet të përmendim se gjatë shekujve dhe mijëvje-

çarëve ka patur dyndje dhe shtegtime popujsh nga një vend tek tjetri, që kanë sjellë e shpënë edhe krijimtarinë gojore, për rrallën.

Si pasojë e atyre që thamë më sipër, shpesh herë tregonjësit ndryshojnë gjatë kohës fushën e zhvillimit të veprimit të heronjve përrallorë, e përshtatin këtë me kushtet e jetës së tyre, me ambientin në të cilin rrojnë, në mënyrë që dëgjonjësit ta kuptojnë më mirë, ta ndjejnë sa më të afërm. Dhe, gjithashtu, shumë herë ata bashkojnë në një përrallë të vetme dy ose tri përralla të tjera ose, përkundrazi, ndajnë një përrallë të vetme në dy-tri përralla të ndryshme, të pavarura. Por ajo që ka rëndësi është përmbajtja ose thelbi shoqëror dhe moral i përrallës, i cili mbetet gjithnjë ai që pat qenë: lufta kundër mbretit dhe pasanikut, kundër dhunëtarit dhe makutit, kundër rrëmbestarit dhe përtacit për fitoren e së drejtës, të së mirës.

Vladimir Iliç Lenini, me pamjen e tij shumë të largët dhe shumë të thellë në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe ekonomike, çmonte shumë lart brendinë dhe rëndësinë shoqërore — politike të krijimtarisë popullore. Kështu, duke çfletuar disa përmbledhje këngësh dhe përrallash popullore ruse, ai i tha një herë sekretarit dhe bash-

këpunëtorit të tij të afërm, V. D. Broç-Brujeviçit: «Sa interesante është kjo lëndë! Shqyrtova kalimthi disa libra të vogla përrallash dhe më vjen keq se më mungon fuqia për të bërë përgjithësimë, për ta kqyrur këtë lëndë nga pikëpamja shoqërore-politike. Duke u mbështetur në këtë lëndë, mund të shkruheshin studime shumë të bukura mbi dëshirat dhe aspiratat e popullit. Shikoni! Përrallat e Onçukovit, që sapo shfletova, përmbajnë pjesë të mrekullueshme. Mbi këtë pikë duhet të tërheqim vëmendjen e historianëve tanë të letërsisë. Kjo është një krijimtari e vërtetë popullore, shumë e nevojshme dhe e rëndësishme për studimin e shpirtit të popullit në ditët tona».

* * *

Në këtë libër të vogël përfshihet një grusht përrallash nga disa vende të Ballkanit. Aty nuk përfshihen përralla shqipe, të cilat lexonjësi ynë i njeh tashmë nga djepi dhe nga vatra, si dhe nga përmbledhjet që ka botuar Instituti i Folklorit ose mbledhës dhe punonjës të ndryshëm.

Lexonjësit do t'i bjerë menjëherë në

sy se shumë përralla të këtij libri, si thelb, u përngjasin përrallave tona. Po ashtu ato i përngjasin njëra tjetrës. Fjala vjen, përralla «Që kur kanë zënë njerëzit të mos vrasin pleqtë» i ngjet përrallës shqipe «Mbreti i lig që vriste pleqtë». Këtë përrallë e gjejmë edhe te shumë popuj të tjerë. Përralla «Vajza e llastuar» i ngjet gjithashtu një përralle shqipe, e cila godet përtësën. Përralla «Tri këshilla për tre florinj» është e njëllajtë me përrallën shqipe «Mëndjen e sotme lere për nesër», e përhapur në shumë krahina të vendit tonë.

Përralla «Mbret Trojani me veshë capi» ngjet gjithashtu me shumë përralla të vëndeve të tjera, dhe të gjitha bashkë i ngjasin përrallës së moçme të mbretit Midas. Thelbi i saj është se e vërteta nuk mund të mbahet shumë kohë e fshehur dhe fundi i fundit del në shesh.

Ajo që ndryshon është trajta, sepse çdo popull i pasqyron përrallat e veta me mënyrën dhe mjetet e tij.

* * *

E këndshme dhe plot kuptim është përralla «Misuri i mrekullueshëm». Aty është

fjala për një misur të gjetur në barkun e një peshku. Ky misur ka vetijën ta bëjë ujën ar. Për këtë misur e bija e mbretit është gati t'i japë Qelogllanit çdo gjë që t'i kërkojë. Ky është një djalë i thjeshtë dhe nuk i kërkon gjë tjetër, veçse të bëjë disa kollo-tumba përpara tij, që ta përulë, ashtu siç e kishte përulur ajo vetë më parë; pastaj ia fal misurin. Mbreti, si mbret, që është, e ndjen veten të fyer dhe e dënon të bijën me vdekje. Mirëpo xhelatit i vjen keq ta vrasë vajzën dhe e lëshon të shkojë ku të dojë. Më vonë, vajza vishet si djalë, pasurohet me arin që bën misuri nga uji, dhe i vete emri në të katër anët e mbretërisë. Mbreti nuk i bën dot ballë tundimit, merr oborrtarët e tij të mëdhenj dhe i vete në shtëpi, po nuk kupton se pasaniku është vajza e tij e veshur si djalë. Ai kërkon t'i falë misurin mrekullibërës. Vajza-djalë është gati t'ja japë, por me një kusht: që mbreti dhe oborrtarët e mëdhenj të bëjnë kollo-tumba përpara saj dhe pastaj ta marrë misurin ai që do të kërcejë më shumë e që do të mbahet gjer në fund. Dhe, për hir të arit — të cilit i falen mbreti dhe oborrtarët — të gjithë këta pleq mjekërbardhë, me mbretin në krye, bëjnë kollo-tumba përpara pronarit të misurit, dërsitin, kapiten. Së fundi, vajza i shfaqet t'et dhe i tregon të

vërtetën: për këtë misur mrekullibërës kish-te bërë edhe ajo, bijë mbreti, kollotumba para Qelogllanit të varfër e zemërmirë. Kjo përrallë është një frushkull që godet me fuqi një shoqëri të kalbur, e cila s'ka dëshirë tjetër, veçse të grumbullojë pasuri, të shitet e përshitet për hir të arit.

Përralla «Ç'të mbjellësh do të korrësh», të cilën e gjejmë edhe te shumë popuj të tjerë, si dhe në gjuhën tonë, përmban një thelb të lartë moral; ai që i bën varrin tjetrit, bie brenda vetë në të.

Përrallat «Siliani që u bë lejlek» dhe «Vajza e llastuar» godasin përtacinë, kurse, përrallat «Guri i vogël shumë i çmuar» dhe «Lauresha e mirë» godasin lakminë, grabitjen. Kur i lexojmë këto përralla, të gjithë gëzohemi, sepse shkopi i magjishëm godet dhe përgjunj mbretin kusar ose grabitësin plak.

E bukur dhe e rrjedhshme është përralla «Përse s'ka më vitore». Po ashtu edhe përralla «Kështu u bë njeriu urith» që dënon lakminë e njerëzve për të pushtuar sa më shumë tokë, duke përdorur gënjesht-rën.

Veç atyre që thamë më lart, përrallat tregojnë edhe pamjen e vendit të çdo populli, zejtaritë e tij e kështu me radhë.

Të gjitha ato tregojnë besim të fortë

ndaj jetës së drejtë dhe godasin dhuno-
njësit. Heronjtë kalojnë nëpër vështirësi dhe
pengesa të mëdha, por i kapërcejnë dhe da-
lin faqebardhë: i dohti fiton kundër të for-
tit, i vogli kundër të madhit, i miri kundër
të ligut, i varfëri kundër të pasurit.

DHIMITËR PASKO

Përralla e Silianit

që u bë lejlek

Rrëfejnë se na ishte një herë një njeri i mirë, punëtor. Bujk ishte. I thoshin Bozhin. Ky kish tre djem e një vajzë. Dy djemtë e mëdhenj i vdiqën dhe i mbeti vetëm i vogli Siliani. Babai e nëna e donin këtë si sytë e ballit, e llastonin, e mbanin në pekule të madhe¹). Siliani vinte në shkollë, po nuk mësonte, nuk dëgjonte mësuesin. I pëlqente vetëm të bridhte në breg të lumit, të lahej e të gjuante peshq. Dalgadal Siliani u rrit, u bë djalë i madh, gati për të martuar, po nuk i shtrohej pu-

nës. Dëfrente, bënte kokrrën e qejfit. I ati dhe e ëma nuk dinin ç'të bënin që ta vinin në udhë të mirë. Fundja kuturisën ta martojnë. Thoshin: do të martohet e do të shtrohet, do t'i vinë mendtë. Dhe e martuan. I dhanë nuse vajzën më të këndshme e më punëtore të fshatit. Nuses i thoshin Neda. Pas një moti kjo lindi një djalë e ia vunë emrin Vellko.

Siliani u martua, po nuk u shtrua, nuk iu vu punës. Babai lëronte e mbillte arën, nëna gatuante, e shoqja, Neda, dhe e motra Bozillka, korrnin, kurse Siliani vishej e ngjishej dhe shkonte në treg për të dëfryer. I ati banonte në fshatin Konjar, afër një qyteti, kështuqë Siliani shkonte dendur në atë qytet, hante bukë të bardhë e ëmbëlsira, ia shtronte me të pirë, me shokë të prishur, siç ishte vetë.

I ati dhe e ëma i thoshin:

— Mos shko, bir, në udhë të shtrembër; mos shko me shokë të këqinj; dëgjo ç'të thonë prindërit. Nuk e ke dëgjuar atë përrallën e qyqes e të bufit? Këta kanë qenë një herë e një kohë njerëz, vëlla e motër, po, meqë nuk dëgjuan prindërit e tyre i zuri mallkimi: vëllai u bë buf, motra u bë qyqe. Qyqja hidhet e kërcen ditën degë më degë dhe klith: «Kuku, kuku!» — kërkon të vëllanë, kurse bufi del natën e thërret «Uh,

uh! — kërkon të motrën. Dhe nuk e gjejnë njëri tjetrin. Kështu edhe ti: po të mos dëgjosh prindërit do të vijë dita kur do të vuash, do të pendohesh, do të derdhësh lot.

I ati dhe e ëma i flisnin dhe e këshillonin kështu, kurse Siliani rrinte shtrirë në shtrat me sytë në tavan. S'kish qejf t'i shikonte e t'i dëgjonte. Numëronte trarët dhe thosh me mëndje:

«Vallë nuk e shihni se po flisni kot më kot? Fjalët tuaja nga njëri vesh më hyjnë, nga tjetri më dalin. Prisni e do të shihni: nesër, sa po të gdhihet, do të shkoj në qytet e nuk do të kthehem më në shtëpi. Më mërzitën fjalët tuaja të kota».

Kështu tha Siliani me mendtë e tija, kështu bëri. Të nesërmen, posa shkrepri drita, u ngrit e shkoi në qytet, nuk u tha një fjalë goje njerëzve të tij: as «mirëmbeci», as «ju le shëndenë», as «mirupafshim», asgjë. Arriti në qytet e hoqi drejt në një han, ku vinte ngahera. Hëngri, piu, pastaj ra të flerë. Dëfreu një ditë, dëfreu dy, dëfreu tri, gjersa mbeti pa një dyshkë në xhep. Kur mbeti pa pare, mbeti edhe pa bukë. Hiqte e vuante nga uria, por nuk desh të kthehej në shtëpi e të punonte si të tjerët.

Dhe ja, një ditë prej ditësh, hyri në han

një prift dhe e pyeti të zotin e hanit:

— A mos di ndonjë njeri që ka qejf të vijë me mua për të bredhur fshatrave e për të mbledhur lëmoshë?

Ky prift donte të shkonte në haxhillëk, në Jerusalem, të bëhej haxhi, po nuk kish pare për udhë. Kështu ai kish menduar të mblidhte lëmoshë fshatrave e pastaj të shkonte në haxhillëk.

Kur dëgjoi Siliani se ç'donte të bënte prifti, u gëzua e i tha:

— O prift, mua s'më pëlqen të punoj. Fshatrat e kësaj ane i njoh mirë. Po të më marrësh në haxhillëk, unë të shpie fshat më fshat për të kërkuar lëmoshë. Kam qejf të bëhem haxhi, që të më bëjnë nder gjithë bota.

U muarr vesh të dy dhe shkuan për lëmoshë fshatrave. Brodhën andej gjithë verën. Mblodhën mjaft pare për të shkuar në haxhillëk. Zbritën pastaj në Selanik, hipën në një anije me pëlhurë dhe u nisën. Era i shpuri larg në det. Anija lundroi sa lundroi mbroth, pastaj nisi një erë e fortë, plasi stuhia. Anija me pëlhurë zuri të kërcejë valë mbi valë e të zbresë poshtë nëpër humnera, gjersa u përplas në një shkëmb të madh e u bë copë. Gjithë njerëzit, bashkë me priftin që donte të bëhej haxhi, u mbytën. Shpëtoi vetëm Siliani, që u kap pas një

dërrase. Valët e rrahën mirë e paq dhe pas-taj e hodhën në breg, gjysmë të gjallë, gjysmë të vdekur.

Siliani u dergj një copë herë të gjatë në anë të detit e nuk i vinte të besonte se gjendej në tokë; i dukej sikur valët vazhdonin ta shpinin tej e përtej, ta përkundnin, ta rrihnin. Më në fund ra në vete, u ngrit e nisi të bredhë në atë tokë që nuk e njihte. Shko-shko, u largua nga bregu, por së fundi arriti në një breg tjetër. Që aty nuk i shihnin sytë veçse det. Vrau sa vrau mendjen dhe e kuptoi se ndodhej në një ishull. Si e mori vesh këtë gjë, u nis të kërkojë ndonjë fshat a ndonjë qytet, por nata e zuri pranë një shpelle. Aty, buzë shpellës kish një burim dhe, afër burimit, një drizë. Siliani mblodhi ca manaferre, i hëngri, piu ujë dhe ra të flerë brenda në shpellë. Po a mund të flerë njeriu në dhe të huaj, në një shpellë të errët? Jo, nuk mund të flerë. Kështu nuk mundi të flerë as Siliani: ai nuk mbylli sy gjithë natën. E pyeste veten: «Ç'farë ishulli është ky? Përse nuk shoh njeri? Përse s'dëgjoj të lehë ndonjë qen a të këndojë ndonjë këndes?»

Më në fund, me që ishte fillikat në dhe të huaj, njeri pa njeri, nisi të qajë me ngashërim, i penduar për të gjitha ato që kish bërë.

— Oh, nënë, moj nënë! Oh, bir, Vellko! Oh, grua e motër! Ç'bëni vallë ju tani? Ndofta qani se ika dhe ju lashë... Po ju nuk e dini sa shumë më ka marrë malli t'ju shoh. Pse nuk ju dëgjova e nuk ndenja në shtëpi? Përse nuk iu vura punës si gjithë bota, po u nisa me atë priftin e mallkuar për haxhillëk? Oh, unë i gjori humba jetën... Më kish shkrepur të bëhesha haxhi që të më bënin nder të gjithë. Eh, sikur të kisha fat të shihja edhe një herë fshatin tim! Edhe ty, baba. Edhe ty, nënë. Edhe ty, bir i vogël, Vellko! Edhe ty, grua! Edhe ty, motër! Po si të shpëtoj nga ky vend i shkretë? Rreth e qark nuk shoh veçse det!

Kështu e kaloi Siliani gjithë natën, duke qërtuar veten për të këqijat që kish bërë. Në të gdhirë u kapit së menduari dhe dremiti pak. Kur u zgjua pa se ndriçonte dielli. Siliani u ngrit, doli nga shpella dhe shkoi të kërkojë njerëzit e vendit.

U ngjiti në një kodër, shikoi rreth e qark. Në një vend, midis një mali e një çuke, i zuri syri një arë. Shkoi andej dhe pa një burrë e një grua që po kositnin bar. Ecte udhës dhe thosh me vete: «Po të jenë bullgarë, do të merremi vesh njëri me tjetrin. Por si mund të ketë bullgarë në një ishull në mes të detit? Po të jenë turq ose

grekë, nuk mund të merremi vesh, sepse unë nuk ua di gjuhën».

Siliani arriti atje ku po, kositnin bar ai burri dhe ajo gruaja, iu fal këtyre me dorë në zemër, por nuk u tha asnjë fjalë, sepse s'dinte ç'njerëz ishin. Burri e gruaja u panë, lanë kosat e i folën në gjuhën e tij, bullgarisht:

— Ç'është kjo punë, vëllako Silian? Pse s'na thua ndonjë fjalë? Apo je trembur kaq shumë dhe ke mbetur pa zë?

Siliani u përgjigj:

— Desha t'iu përshëndes, po nuk më shkonte në mend se ju dini gjuhën time amtare. Tani shoh se ma ditki edhe emrin. Unë ju shoh për herë të parë e nuk e marr dot me mendje që ku ma dini emrin.

Burri i tha:

— Silian, ty të solli era në një vend ku s'ka shkelur këmbë njeriu. Ne të njohim. Ulu të marrësh veten. Na, pak bukë e djathë. Si të mbarosh së ngrëni do të shkojmë bashkë në shtëpi. Atje do të themi që ku të njohim e përse të themi me emër.

Siliani ndenji poshtë, hëngri bukë me djathë, se ishte shumë i uritur.

Kur u ngrys, burri e gruaja e shpunë Silianin tonë në shtëpi të tyre. Sapo shkelën brenda në oborr, fëmijët thirrën me të madhe:

— Shikoni, shikoni! Po vjen Siliani i Konjarit!

Siliani u çudit e fërkoi sytë: «Ç'është kjo punë? A mos shoh ëndërr? Që ku ma dinë emrin këta fëmijë? Unë s'i kam parë kurrë!»

Hyri brenda në shtëpi. Gjithë ata që ishin aty e përshëndetën e i thanë:

— Mirë se erdhe, Silian!

Ndenjën të hanë darkë. E gostitën me gjellët më të mira, si mysafir të shtrenjtë.

Pas darke erdhën fqinjtë. Sapo e panë Silianin, thanë:

— O Silian, ç'të paska fryrë era këtej, në vendin tonë?

Siliani e pa se gjithë fshati e njihte, kurse ai nuk njihte njeri. S'do mend; u habit shumë e më shumë. Fqinji plak u ul e ndenji pranë Silianit dhe nisi ta pyesë:

— Hë, Silian, bir! Pa më thuaj si e ka babanë, Bozhinin. A është shëndoshë e mirë? Po nëna si është? Si e ke Vellkon e vogël? Po Nedën? Po Bozillkën? Të gjithë shëndoshë e mirë? Grindesh më me babanë për punën e rakisë apo hoqe dorë nga të pirët?

— Jo, — u përgjigj Siliani, — s'kam hequr dorë. Nga ky shkak u largova nga babaj e nga nëna, nga gruaja e nga djali, nga motra, nga të gjithë. Siç duket në këtë

punë ka gisht vetë djalli. Ai më shtyu në udhë të keqe. Po të mos kisha pirë nuk do të më ndodhte kjo që më ndodhi... Po ju që ku më njihni? Që ku njihni njerëzit e mi të afërm?

— Kemi ndenjur në fshatin tuaj, në Konjar, kur t'i s'kishe lindur ende, — i tha plaku. — Edhe tani çdo pranverë ngrihemi e shkojmë në Konjar dhe kthehemi përsëri në vjeshtë në ishullin tonë. Kemi ndenjor edhe në shtëpinë tuaj, kështu që të njohim mirë. I njohim emër më emër gjithë njerëzit e shtëpisë dhe gjithë njerëzit e fshatit.

Siliani rri e vret mendjen. «Ç'është kjo punë? — thotë. — Këta njerëz nuk i njoh; tani i shoh për herë të parë. Megjithatë, këta thonë se më njohin. Jo vetëm mua, po të gjithë të shtëpisë sime dhe të gjithë fshatarët e mi!» Dhe Siliani iu lut plakut që t'i thosh të vërtetën. Atëhere plaku i tha:

— Dëgjo, Silian. Në pranverë ne, të gjithë, bëhemi lejlekë dhe shkojmë në fshatin tuaj. Atje kemi çerdhet. Lart, në pullazet e shtëpive. Nga pullazet shohim çdo gjë që ndodh në fshat. Në mbrëmje, kur njerëzit mblidhen pranë vatrës, ne dëgjojmë se ç'bisdojnë njëri me tjetrin.

— Si është e mundur të bëheni lejlekë?
— pyeti Siliani. — Ju jini njerëz!

— Po, ne jemi njerëz, — u përgjigj plaku. — Jemi njerëz si gjithë njerëzit e tjerë, por bëhemi lejlekë, sepse e kemi mallkim nga stërggjyshët. Atëhere unë kam qënë djalë i vogël dhe isha pleksur me djem të liq, të paudhë. Ne nuk u bindeshim prindërve, ishim të llastuar, bënim marrëzira. Gjithë fshati qahej e ankohej. Gjithë njerëzit na qortonin e na këshillonin që t'u bindeshim të mëdhenjve, të mos ngisnim, të mos bënim të këqija, të mësonim. Por ne s'donim t'ia dinim. Një herë erdhi në fshatin tonë një plak i panjohur. Ne zëmë ta ngacmojmë, ta ndjekim, ta tallim. Ai u zemërua e na kërcënoi me shkop. Ne ia kthyem me gurë. Një nga këta gurë i ra në kokë. Plaku vdiq. E varrosën nën një sallkëm¹⁾. Ndërsa po e mbulonin me dhe, plaku nisi të flasë nga varri. Ai i mallkoi gjithë ata që i kishin hedhur gurë të bëheshin lejlekë, të shkonin në vjeshtë larg, në vende të huaja, dhe të ktheheshin në pranverë në vendin e tyre. Tha edhe se atje, nën një dru, dalin dy burime: njëri me ujë lejleku, tjetri me ujë njeriu. Kështu, sapo vjen pranvera, njerëzit lahen me ujin

1) Shelg vajtues.

e lejlekëve dhe bëhen lejlekë; kur vjen vjeshta lahen me ujin e njerëzve dhe bëhen përsëri njerëz. Që atëherë, — tha plaku, — çdo pranverë ne shndërrohemi në lejlekë dhe fluturojmë përtej detit, gjer në fshatin tuaj. Rrojmë me bretkosa e me gjarpërinj. Në vjeshtë kthehemi në ishullin tonë, lahem me ujin e njeriut dhe bëhemi përsëri njerëz.

— Më thuaj, xhaxho, ç'të bëj që të kthehem në fshatin ku kam lindur? — e pyeti Siliani. — Nuk vjen këtu ndonjë anije?

— Jo, Silian, këtu nuk vijnë anije. Brigjet e ishullit tonë janë shumë të thepisur, shkëmborë. Po të afrohet ndonjë anije këtej valët e përplasnin te shkëmbenjtë dhe e bëjnë copë. Po sidoqoftë, do të bëjmë si të bëjmë që ti të kthehesh në fshat. Kur të vijë koha të shkojmë në Konjar, lahu në burimin e ujit të lejlekëve bëhu lejlek dhe eja bashkë me ne në Konjar. Por më parë mbush një pagur me ujë njeriu, lidhe këtë pagur me një spango dhe vare në qafë. Sapo të kthehemi në fshatin tënd, lahu me këtë ujë që të bëhesh përsëri njeri dhe të kthehesh prapë te njerëzit e tu të afërm.

Siliani nuk u zuri besë fjalëve të plakut. Atëherë plaku e shpuri te burimi, u la me ujë dhe u bë lejlek. Fluturoi një copë herë poshtë e lart, pastaj zbriti, u la në burimin

tjetër dhe u bë prapë njeri. Atëhere Siliani besoi se mund të kthehej prapë në fshatin e tij dhe u gëzua shumë, iu lut plakut;

— Haj të shkojmë sa më shpejt në fshatin tonë!

— Jo, Silian, kjo është punë që s'bëhet. Tani atje është dimër. Ti e di se lejlekët janë zogj që nuk durojnë dot të ftohtin. Prandaj ata ikin në vjeshtë për në vendet e ngrohata. Bëj durim. Do të vijë koha të shkojmë andej.

Siliani ndenji gjithë dimrin në atë ishull të panjohur, që ndodhej përtej nëntë deteve. Tani ish ndryshuar shumë. Nuk ishte më ai Siliani i parë që nuk i bindej babait e nënës e që nuk desh të punonte. Nisi të punojë gjithë ditën me fqinjët e tij dhe nuk vinte në gojë verë e raki. Priste me pa durim kohën kur do të bëhej lejlek dhe do të kthehej në fshatin e tij.

Më në fund sosi pranvera. Të gjithë banoesit e ishullit të largët u lanë në burimin e ujit të lejlekëve dhe u bënë lejlekë. U la edhe Siliani dhe u bë lejlek, si gjithë të tjerët. Vari në qafë një pagur me ujë nga burimi i ujit të njeriut dhe u nis për në Konjar bashkë me lejlekët e tjerë. Fluturuan tri ditë e tre net, u çlodhën pak dhe fluturuan përsëri. Kështu arritën në fshatin Konjar Siliani pa fshatin ku kish lindur, pa

shtëpinë e tij, u gëzua shumë, po harroi fare pagurin me ujë njeriu që kish varur në qafë. Ai u vërvit me vrull në tokë, paguri u përplas në një gur dhe u thye. Uji, që do ta bënte përsëri njeri, u derdh. Kështu, Siliani s'kish me se të lahej dhe të bëhej prapë njeri. Mbeti lejlek. Shtangu në vend, qau me lot, po s'kish ç'të bënte: ajo që shkoi, shkoi. Siliani hapi krahët e fluturoi mbi pullaz të shtëpisë së tij, në çerdhen e lejlekut plak. Aty lejleku plak tha:

— Silian, kjo është çerdhja ime; ti shko tej, në atë çerdhen që gjendet në shtëpinë tjetër.

Ç'të bënte Siliani? Hapi krahët e fluturoi mbi pullazin e shtëpisë tjetër dhe që atje shikoi oborrin e tij. Pa nënën që po milte lopën, pa të shoqen — Nedën e bukur — që po milte dhentë pa të motrën, Bozillkën, që po ndizte zjarrin për të gatuar drekën. Të gjithë punonin, kurse Siliani, si një herë e një kohë, rrinte pa punë. Mirëpo kësaj here atë e kish marrë malli për njerëzit e tij, donte t'u afrohej shumë e më shumë. Hop! zbriti në oborr dhe nisi të shëtisë midis qengjave të vegjël. Atëhere doli vrap nga shtëpia i biri, Vellkua i vogël. Kur e pa lejlekun, vogëlushi i thirri nënës:

— Nënë, nënë! Lejleku kërkon t'u bjerë me sqep qengjave të mi!

— Dëboje, bir, dëboje! — i tha e ëma.

Vellkua mori një gur dhe ia hodhi Silianit në kokë, mënt e vrau. Silianit iu muar mendja. U mundua të fluturojë, po nuk mundi. Vellkua e zuri për këmbë dhe i thirri përsëri s'ëmës:

— Nënë, nënë! E zura lejlekun! Do t'i lidh një gjalm në këmbë dhe do të loz me të.

— Jo, bir, jo, — i tha e ëma. — Lëshoje lejlekun e gjorë. Ai nuk u bën keq njerëzve, por vetëm mirë.

Vellkua e dëgjoi dhe e lëshoi lejlekun. Siliani fluturoi dhe qëndroi përsëri majë pullazit.

Pas disa ditësh Siliani ndërtoi një çerdhe të re dhe banoi afër njerëzve të tij.

Dhe ja një ditë i ati, Bozhini, shkoi të lërojë arën dhe e mori me vete të nipin që të hiqte qetë. Silian-lejleku hapi krahët dhe fluturoi pas tyre, i ndoqi gjersa arritën në arë. Aty zbriti në tokë pranë e pranë të birit. Kështu, Siliani nisi të ecë prapa parmendës, nëpër brazdë. I biri e pa dhe thirri:

— Gjysh, gjysh! Ky është lejleku ynë që ha bretkosa!

— Lere të qetë, nip, — i tha gjyshi. — Lejleku nuk na pengon punën.

Lëruan sa lëruan, pastaj Vellkua i vogël i thirri përsëri gjyshit:

— Shiko, gjysh! Lejleku nuk na ndahet. Na ndjek nga prapa.

— Lere Lejlekun, nip; ngaji qetë më shpejt, se ja tani do të erret e bëhet natë.

Mirëpo Vellkua bën ç'bën dhe kthen kokën prapa që të shohë lejlekun. Gjyshi zemërohet dhe i thërret:

— Ç'po bën ashtu, o nip? A mos të mora në arë që të rrish pa punë dhe të shikosh lejlekët?

Plaku u zemërua shumë, ngriti hostenin që ta dëbojë lejlekun, po pa dashur ia goditi këmbën. Silian-lejleku u ngrit në erë dhe u kthye në shtëpi, qëndroi majë pullazit në një këmbë, në të shëndoshën, futi tjetrën nën krah dhe nisi të qajë. Këmba e goditur i dhimbte shumë.

Në mbrëmje të gjithë të shtëpisë u kthyen nga puna dhe ndenjën të hanë bukë te vatra. Siliani u struk në çerdhen e tij majë pullazit dhe mbajti vesh të përgjojë se ç'do të thoshin. Vellkua i vogël i tha s'ëmës:

— Nënë, sot lejleku ynë erdhi në arë tek lëronim; gjyshi mori hostenin e bum! — ia theu këmbën.

Gjyshi i tha:

— Fajin e ke ti, Vellko. Pse ktheje

gjithnjë kokën për të shikuar lejlekun dhe harroje të ngisje qetë? Më vjen keq për të gjorin lejlek. Zgjata hostenin dhe e godita pa dashur.

— Më mirë të më kishe goditur mua sesa godite lejlekun tonë, — tha i biri i Silianit.

Siliani i dëgjonte të gjitha; ai rrinte në çerdhen e tij majë pullazit dhe qante, qante...

Një ditë e motra, Bozillka, rrinte në oborr dhe bënte një gjerdan me pare të vogla, të shpuara. Punoi sa punoi, pastaj hyri brenda në shtëpi të pijë ujë; gjerdanin e la në rrogoz. Sapo hyri Bozillka brenda, Siliani zbriti në oborr, mori gjerdanin në sqep dhe e shpuri në çerdhen e tij, lart mbi pullaz. Një ditë tjetër e shoqja e Silianit shtroi rrogozin në oborr dhe zuri të qëndisë me pe të zi një këmishë. Qëndiste e qante, si e ve që ishte:

— Oh, sa keq më vjen për të gjorin Silian që u mbyt në det kur shkoi në atë të mallkuar haxhillëk! Unë desha që ai të rronte në shtëpi, me të gjithë të afërmit tanë. Po kështu, i mjeri Silian, s'ka as varr ku të prehet...

Gruaja qan e mallkon. Siliani i dëgjon të gjitha atje lart dhe lotët i venë breshër. Pas pak Neda shkoi s'di se ku. Silian lej-

leku zbriti, mori lëmshin në sqep dhe e fshehu në çerdhen e tij.

Shkoi një muaj. Arriti dita të martohet motra e Silianit. Erdhën krushqit me dhëndrin, ranë gazet, dasmorët ia krisën valles me të hedhur e të kërcyer. Në këtë kohë Siliani rrinte në pullaz këmbëthyer, shikonte e thosh me mendje: «Eh, eh! Sa qejf do të kisha të hidhja edhe unë valle!» Krushqit hynë brenda në shtëpi, të hanë e të pinë, ndërsa Neda e mori Vellkon për dore dhe shkoi në fund të oborrit të vajtojë të shoqin e vdekur. Siliani e dëgjonte nga pullazi dhe zemra i bëhej copë.

Dhe ja, më në fund, u erdhi koha lejlekëve të shkonin në vendet e ngrohta. Ata u mblodhën të gjithë në breg të lumit, hëngrën bretkosa sa u nginë, pastaj u ngritën e fluturuan. Udhëtuan tri ditë e tri net, pastaj edhe tri ditë e tri net të tjera, gjersa arritën në ishullin e lejlekëve.

Siliani kaloi edhe pesë muaj të tjerë në dhe të huaj, gjersa sosi pranvera dhe u erdhi koha lejlekëve të kthehen përsëri në Konjar. Dhe ja, Siliani mbushi edhe një herë një pagur me ujë nga burimi që e bënte lejlekun njeri, e lidhi mirë e mirë në qafë dhe u nis bashkë me lejlekët e tjerë për në fshatin ku kish lindur.

Fluturuan e fluturuan mbi male e dete

gjersa arritën në Konjar. Siliani zbriti në oborrin e babait, mbi grunarët e renditur në oborr. Hyri brenda, u la me ujin e pagurit dhe u bë përsëri njeri, tamam ai Siliani i dikurshëm, i biri i Bozhinit, i shoqi i Nedës, i ati i Vellkos, i vëllai i Bozillkës. Pastaj doli nga grunarët, eci nëpër oborr, drejt derës së shtëpisë. Aty e pa qeni, Dhëlpërushi, po nuk e njohu dhe filloi të lehë. Siliani i tha:

— Pse leh, o Dhëlpërush? Nuk më njeh? Unë jam yt zot, Siliani.

Sapo ia dëgjuan zërin, dolën të gjithë nga shtëpia dhe e përqaftuan Silianin. Oh, sa shumë u gëzuan! Siliani e mori në krahë Vellkon e vogël dhe zuri ta puthë; ai harroi fare se pranverës së kaluar, kur kish qenë lejlek, Vellkua e kishte goditur në kokë me një gur. I ati i Silianit porositi të sjellin raki që ta gostitë të birin, por ky nuk desh të pijë.

— Kam hequr e kam vuar shumë nga kjo raki e mallkuar, sepse atëhere nuk dëgjoja babain dhe nënën, prandaj jam betuar që të mos vë më verë e raki në gojë dhe t'i shtrohem punës. Babai kish të drejtë kur thosh: kush s'punon, s'ha.

Kur dëgjoi këto fjalë, babai u gëzua shumë, theri dashin më të majmë, që kish në tufë dhe ftoi në gosti gjithë fqinjët.

Hëngrën e pinë dhe ndërkaq e pyetën Silianin se ku kish qenë dhe ç'kish parë në botë.

Siliani ua tregoi të gjitha ato që i kishin ndodhur, që në krye e gjer në fund, por askush nuk i zuri besë se ai kish qenë lejlek. Atëhere Siliani hipi në pullaz të shtëpisë, mori nga çerdhja gjerdanin e së motrës dhe lëmshin e zi të së shoqes dhe ua tregoi të gjithëve. Pastaj u tregoi se si i ati e kish goditur me hosten dhe ia kish plagosur këmbën. Atëhere i besuan të gjithë dhe bënë be që të mos i godisnin kurrë lejlekët.

Vajza e llastuar

Ishin një herë në një fshat një burrë e një grua. Kishin një vajzë të vetëme, që e donin edhe e mbanin si sytë e ballit gjithnjë në pekulë veç botës, gjithnjë të veshur veç botës, gjithnjë të ushqyer veç botës. E llastonin kaq shumë saqë gjithë fqinjët e gjithë fshatit i thoshin «vajza e llastuar».

Kjo vajzë e llastuar nuk bënte asgjë, po vetëm rrinte e flinte, hante e pinte. Të gjitha ia sillnin në sofër, gati. Sapo ngrysej, ajo binte e flinte e bënte gjumë për kokën e gjumit gjer të nesërmen më drekë herë. Kur zgjohej nga gjumi, vinte e ëma dhe e ngrinte nga shtrati, e lante, e krihte, e vish-

te me të reja nga koka gjer te këmbët, i sillte të hante. Si mbaronte këto të gjitha, i shtronte një qilim pranë vatrës dhe rri të rrimë, pa punë, pa zanat, gjithë ditën. Kur i vinte uria, e ëma i sillte për të ngrënë e për të pirë aty, në qilim, te vatra. Dhe nuk i sillte ushqime dosido, po vetëm të mira. Ç't'i kërkonte goja, ç't'i tekej. «Dua këtë!» — «Na!» — «Dua më!» — «Na, na!» Kur mardhte pak, thërriste: «Afromëni te zjarri! Shpejt!» Dhe suleshin ata të dy — nëna e babai — dhe e afronin te zjarri, që të ngrohej. Kur nxehej shumë, prapë thërriste: «Largomëni! Largomëni!» Dhe prindërit e largonin nga zjarri.

Sot kështu, nesër kështu, ha e pi, rri e fli, u rrit vajza e llastuar e u bë, si të thuash, e pjekur për martesë.

Zunë të vijnë lajmësit që ta kërkojnë për akëcilin, nga afër e nga larg. Me të ardhur lajmësit në derë, dilte e ëma dhe i priste, u tregonte gjerë e gjatë se si e kish rritur çupën me kulaç të grynjtë e thelpinj arre, se si e kish mbajtur në pëllëmbë të duarve, se si e kish veshur, shkurt: me pekule e stërpekule, me njëmijë të mira. Me të numëruar këto të gjitha kthehej dhe pyeste:

— Unë e jap që sot time bijë, po dua të di një gjë: në shtëpinë ku do të vejë a do

ta mbajnë kështu siç e kemi mbajtur ne këtu? Se vajza jonë s'është si të tjerat.

Kur dëgjonin këto fjalë, lajmësit tundnin kryet të habitur, pastaj ngriheshin e shkonin të gjenin ndonjë nuse tjetër, punëtore, se asnjëri s'kish nge ta mbante gjithnjë me përkëdhelje e me nina-nana vajzën e llastuar. Kështu erdhën e shkuan shumë lajmës dhe të gjithëve nëna u tha gjerë e gjatë se si e mbante e se si e llastonte të bijën. Asnjë nga ata nuk u kthye prapë.

Më në fund erdhi një djalosh nga një fshat tjetër, që e kërkoi vetë vajzën e llastuar. E ëma e kësaj doli e i tha:

— Dëgjo, bir, fjalët që do të të them unë. Vajza jonë s'është si të tjerat. Ajo është mësuar të bjerë e të ngrihet kur do vetë, të hajë ç'i do qejfi. Të ngrënët ia sjellim ne vetë, me duart tona. Po ashtu, me duart tona e shpiem në shtrat dhe e ngremë nga shtrati. Pas buke e vemë të rrijë në qilim, te vatra. Po të mardhë, e afrojmë te zjarri, po të ketë të nxehtë, e largojmë. Punë nuk bën, se ajo s'është si të tjerat. Është veç botës. Më thuaj tani bir: a mund ta mbash ti kështu vajzën tonë? Po të mundësh ta mbash, ta japim, po të mos mundësh, nuk ta japim.

— Mos ki merak, moj teto! — i thotë djali. — Unë do ta mbaj edhe më mirë

se sa e kini mbajtur këtu. Do t'i sjell të ngrënë e të pirë, të gjitha te dora: merr e ha, merr e pi. Do t'i shtroj një qilim të butë pranë vatrës, do ta afroj e largoj kur të dojë sapo të japë urdhër. Në shtëpinë time do t'i ketë të gjitha të mirat. Do ta mbaj mbi krye e sipër.

Kështu, të mos e zgjatim, djali dha fjalën se do ta mbante të shoqen më mirë se ç'e kishin mbajtur prindërit. Dhe ia dhanë. Keq, mirë-punë e tyre: bënë dasmë dhe e martuan.

Dhe ja djaloshi e mori në shtëpi të tij dhe nisi ta përkujdesë vajzën e llastuar. Shtroi një qilim përpara vatrës dhe e vuri të ngrohet pranë zjarrit. Ajo u nxeh shumë, se zjarri ishte i fortë, dhe thirri:

— Largomëni nga zjarri! Largomëni!

Mirëpo i shoqi kishte shkuar s'di se ku, në punë. Zjarri digjte e përvëlonte.

Vajza e llastuar thirri përsëri:

— Largomëni nga zjarri, se u dogja! Largomëni!

Nuk erdhi askush ta largojë. Pa ç'pa, u largua vetë, që të mos digjej.

Një ditë tjetër burri shtroi një shtresë sidokudo në oborr, e vuri të shoqen të rrijë atje dhe shkoi. Dita ishte e ftohtë. Vajza e llastuar ndenji sa ndenji në oborr, zuri të mardhë dhe thirri:

— Shpimëni brenda! Shpimëni brenda!

Thirri sa thirri, po askush nuk erdhi ta marrë e ta shpjerë brenda, ta vërë pranë zjarrit. Megjithatë, ajo vazhdoi të thërresë edhe një copë herë, gjersa i mardhën kokat, nuk duroi dot më tej, u ngrit më këmbë dhe hyri brenda, shkoi u ul pranë vatrës.

Ditën e enjte, pas dasmës, i shoqi u ngrit më herët, mbrehu qetë dhe shkoi të lërojë arën. Lëroi sa lëroi, pastaj u kthye në shtëpi për drekë. Po ç'të shohë? Nusja rrinte shtrirë dhe priste që dikush t'i gatuante për të ngrënë dhe pastaj ajo të shtrohej të hante.

Të nesërmen i shoqi shkoi prapë në arë për të lëruar. Para se të nisej mori sëpatën, e vari në një gozhdë të ngulur në mur, mbi shtrat, dhe i tha:

— Dëgjo ti, sëpatë: unë po shkoj të lëroj. Ti të zbresësh nga gozhda, të fshish shtëpinë, ta pastrosh mirë e mirë pastaj të gatuash drekën. Kur të vij nga ara, ti të dalësh të më presësh, të ç'mbrehësh qetë, t'i lidhësh në grazhd, t'u shtiesh kash-të. Edhe mua të më shtiesh ujë për të larë duart e pastaj të shtrosh drekën.

Si e porositi sëpatën ç'punë duhej të bënte, i shoqi shkoi të lërojë. Nusja, që rrinte shtrirë, por nuk flinte, i dëgjoi të gjitha. I dëgjoi dhe u çudit: si është e

mundur që sëpata të bëjë të gjitha këto punë? Ndenji sa ndenji shtrirë, pastaj e mori uria. Shikoi sëpatën e i tha:

— Moj sëpatë, pse rri ashtu varur e nuk lëviz nga vendi? Të marrë djalli! Ta dish se po të ngrihem, do ta pësosh. Nuk merr vesh se mua më hahet bukë?

Sëpata nuk u tund fare nga gozhda. E si të tundej, kur ajo ishte sëpatë si gjithë të tjerat — hekur e dru?

U bë mesditë. Burri u kthye nga ara. Fërshëlleu në oborr, po askush nuk doli nga shtëpia. Çmbrehu qetë, hyri brenda, mori sëpatën nga gozhda dhe nisi ta godasë në një gur me sa fuqi kish, sa e bëri copë. Në dorë i mbeti vetëm një copë bishti dhe një copë nga tuni. U kthye përsëri, vuri mbeturinat e sëpatës në gozhdë e tha:

— Të pëlqen kështu? Në qoftë se të pëlqen, mos bëj as nesër ç'të të them unë dhe ke për të parë.

Të nesërmen burri u ngrit pa gdhirë, e porositi përsëri sëpatën — copën që kishte mbetur — se ç'duhej të bënte dhe shkoi të lërojë. Nusja priti sa priti që sëpata të lëvizte nga vendi dhe t'i përvishej punës, po ajo — e mallkuara! — ndenji varur siç kish qenë. Atëherë vajza e llas-tuar i thirri;

— Sëpatë, moj sëpatë! Zbrit nga gozhda dhe bëj ç'të thanë, se ndryshe do ta pësosh siç e pësove dje!

Sëpata rrinte e heshtur. Nusja vrau sa vrau mendjen dhe më në fund tha: «Kam frikë se do ta pësoj edhe unë siç e pësoi dje sëpata». U ngrit, fshiu shtëpinë, lau dyshemenë, gatoi drekën dhe, kur i shoqi u kthye nga ara, doli ta presë te porta e oborrit. Me të hyrë brenda, ajo u turr e çmbrehu qetë, i lidhi në grazhd, u hodhi kashtë. Pastaj u kthye e i shtiu të shoqit ujë për të larë duart e shtroi sofrën. Ai hëngri, ajo i shërbeu. Si mbaruan së ngrëni, nusja u ngrit nga sofrë e tha:

— Të gjitha i kemi mirë në shtëpi, o burrë, po kemi një të keqe: sëpatën e thyer. Nuk e shoh dot me sy këtë sëpatë të pabindur. Të lutem, po të mundësh hiqe nga gozhda, që të mos e shoh më.

Burri kërceu më këmbë, mori sëpatën, e hodhi tej, në oborr, e tha:

— Ik, sëpatë e pabindur, të marrtë djalli!

Që atë ditë nusja e re iu përvesh punës dhe punoi me kaq zell sa gjithë njerëzit mbetën të çuditur. Fqinjët dhe gjithë fshatarët i kishin zili djaloshit të varfër që kish marrë një grua aq punëtore.

Hajde-hajde, pas ca kohe na vajti fjalla në fshatin e nuses se kjo i qënka përveshur punës. E ëma, sapo dëgjoi se vajza e saj e llastuar punonte si gjithë nuset e tjera, u zemërua shumë dhe zuri të grindej me të shoqin: pse e martoi të bijën, pse nuk e mbajti në shtëpi... Pastaj zuri t'i thotë: «Shko sa më shpejt të shikosh se ç'bën çupa jonë. Në qoftë se janë të vërteta ato që thotë bota e çupa mundohet në punë, merre sa më shpejt dhe sille këtu, që ta mbajmë si më parë.»

S'po e linte të qetë të gjorin plak, e brente si krimbi drunë. Plaku s'kish nga t'ia mbante! Dashje pa dashje, i hipi gomarit e shkoi tek e bija. Në këtë mes dhëndri dëgjoi se do t'i vinte vjehrrin për gosti, zgjoi atë ditë më herët të shoqen, i tha të bënte një kulaç të grynjtë e të therte një pulë. Pastaj u nis e shkoi në arën që gjendej në udhën ku do të vinte plaku:

Lëroi sa lëroi, dielli u ngrit lart e më lart. Dhe ja na e pa të vjehrrin që po vinte kaluar mbi gomar. La parmendën dhe qetë, doli në udhë dhe e priti plakun me shumë nderime. I vjehrrin i thirri nga larg:

— Mirëmëngjes, bir! Ti qenke punëtor i madh! Të lumtë! Mirë se të gjeta!

— Mirë se ardhe, o im vjehërr — iu përgjigj dhëndri.

I dhanë dorën njëri-tjetrit, u përshëndoshën e shkuan të dy në shtëpi. Ecin e bisedojnë shtruar, Arrinë. Nusja doli në oborr, priti me dashuri burrin e babanë, i gostiti siç u kish hije. Të dy të rinjtë biseduan mirë e bukur me plakun dhe pastaj e përcuellën.

Kështu, plaku u nis për në shtëpi. Shkoi i gëzuar. Me të arritur në shtëpi nisi e i tregoi së shoqes se si të dy të rinjtë punonin bashkë e rronin mirë. Plaka u ngrys, vari vetullat, nuk donte të dëgjonte asgjë, shkuli leshrat, tha se do të shkonte vetë të shihte të bijën. Plaku s'donte ta linte të nisej, po s'kish ç'të bënte. Kështu, plaka shkoi te e bija. Dhëndri dëgjoi se po i vinte vjehrra në shtëpi dhe shkoi përsëri të lërojë në arën që gjendej afër udhës. Të mos e zgjatim, aty nga dreka u duk plaka. Sapo e pa të dhëndrin, nga larg, nisi me të sajat:

— A ti, qen i qenit! Ti s'je dhëndër, po bir gomarice, bir bushtre! Si s'pate turp ta vësh në punë time bijë, që e kam rritur si dritën e syve, me pekule të mëdha? Ajo s'është si të tjerat. Ajo është veç botës! Po të mos ishe i zoti ta përkëdhelje e ta mbaje.

në pëllëmbë të dorës, atëhere pse e more për grua?

Vjehrra ktheu nga udha, hyri nëpër arën e lëruar dhe iu turr si e tërbuar të dhëndrit, mori ca plisa e zuri t'ia hedhë në kokë. Ai bën sikur nuk shihte e nuk dëgjonte: ngiste qetë, lëronte arën.

Plaka u lodh së thirruri e së hedhuri plisa, u kthye e shkoi drejt në shtëpi të dhëndrit, vrapoi me të katra. Por ç'i panë sytë? E bija kish përveshur krahët, shkonte e vinte nëpër shtëpi: fshinte, lante, pastronte, gatuante.

E ëma u çudit e nisi ta pyesë:

— Më thuaj, moj bijë: a të llaston yt shoq? Të afron te zjarri kur ke të ftohtë? Të largon kur ke të nxehtë?

Vajza iu përgjegj:

— Jo, nënë, nuk më afron e nuk më largon.

— Të gatuan gjellë e t'i sjell në shtrat, që t'i hash?

— Jo, nënë, nuk më gatuan e nuk më sjell gjellë në shtrat.

— Ah, qeni i qenit!

Nis të ngryset. Nusja ngrihet të dalë që ta presë të shoqin. Nëna e pyet:

— Ku po shkon, bijë?

— Ti rri këtu, nënë, — përgjigjet e

bija, — unë do të shkoj. Im shoq më ka porositur që të dal ta pres kur kthehet nga puna. Kështu bëj ngaherë: në mbrëmje del ta pres, në mëngjes shkoj ta përcjell në arë.

— Jo, mos dil, bijë! Qeni i qenit! Nuk mund të vijë vetë në shtëpi? Nuk mund të shkojë vetë në arë? Dashka ta presësh e ta përcjellësh!

Nusja bëri ashtu si i tha e ëma: ndenji në shtëpi e nuk doli ta presë të shoqin.

Më në fund arriti burri nga ara. E qortoi të shoqen se nuk doli ta presë, kurse vjehrra nisi përsëri ta qortojë, t'i thotë fjalë shumë të rënda.

— Shtro sofrën, — tha burri. — Kam uri si ujk. Mbush dy misurë me supë. Sill bukën.

Nusja mbushi dy misurë me supë, solli bukën. Burri mori bukën, e ndau më dysh. Njërën copë ia dha gruas e i tha:

— Ha!

— Po mua s'më jep? — pyeti plaka. Dhëndri u kthye e i tha:

— Ty? Ti e ke gojën të artë, e mëson çupën të mos punojë. Kështu pra të kam gatuar një ushqim të artë, si të ka hije.

Me të thënë këto fjalë doli në oborr, mori ca kashtë nga plevica, mbushi plot një

trastë. Hyri pastaj në shtëpi, ia varë trastën në qafë së vjehrrës e i thirri:

— Ha kashtë! Ha kashtë!

Plaka u bë veri nga inati, kërceu më këmbë, hoqi trastën nga qafa e thirri:

— Unë nuk do të shkel kurrë më në këtë shtëpi! Ika!

Dhe doli duke përplasur derën.

Iku e nuk shikoi prapa, nuk u ndal fare. Arriti me një frymë në shtëpi, nisi të thërresë e bërtasë me të madhe, ta qortojë plakun. Ky ia ktheu:

— I lumtë dhëndrit. Bëri shumë mirë! Sipas kokës kësulën. Të thashë se vajza jonë rron mirë, të thashë të mos shkosh. Ti nuk më dëgjove.

Ja kështu ndodhi! Burri nuk e preku as me gisht të shoqen, po vetëm e trembi dhe e mësoi se duhet punuar. Vjehrra u mundua ta pengojë të bijën që të mos punojë, po më kot. Pastaj ata të dy rruan e trashëguan.

Të dymbëdhjetë muajt e vitit

Po e nisim përrallën. Qofshi të gëzuar të gjithë ju që dëgjoni.

Ishte një herë një plakë e mjerë e shumë e varfër. Një ditë plaka u nis e shkoi të mbledhë karthje për dimër. Mblidh-mblidh, hyri në ca ara të punuara. Në krye të këtyre arave, rrëzë një mali, pa një shtëpi. Kur po mblidhte karthje zuri të bjerë një vesë shi. Që të mos largohej, plaka shkoi në këtë shtëpi për të gjetur strehë. Sapo hyri brenda pa dymbëdhjetë djem të rinj shumë të bukur.

— Mirë se ju gjeta, djem, — u tha plaka.

— Mirë se erdhe, moj plakë e mirë,
— ia kthyen ata. — Ç'të ka sjellë këtej në
një kohë kaq të keqe?

Plaka u tha:

— Unë, o djem, kam dalë të mbledh ca
kARTHJE për dimër, se jam e varfër dhe
shtëpia ime nuk është shtëpi, po kasolle,
e prishur. Në këtë kasolle era, shiu dhe të
ftohtit hyjnë nga të katër anët.

Atëherë njëri nga djemtë e pyeti:

— Na thuaj, moj nëne, cili është muaji
më i keq i vitit?

— O djem, — tha plaka, — nuk ka
muaj të keq. Sikush ka të mirat e tij. Të
gjithë muajt qofshin të bekuar, se që të
gjithë janë të mirë.

— Ç'po thua kështu, moj nëne? A mos
muaji janar është njëlloj si muaji maj?

— O djem, — tha plaka, — në qoftë se
nuk do të binte shi e dëborë në janar, si
do të vinte maji plot me lule? Unë po ju
them edhe një herë se të gjithë muajt janë
të mirë. Qofshin të bekuar!

— Atëherë djemtë i thanë:

— Ke ndonjë trastë, moj nëne?

Plaka nxori e u dha trastën që kish
marrë për të mbledhur barishta që të ga-
tuante ushqim. Djemtë ia mbushën këtë
trastë plot me florinj. Plaka mori trastën e
u kthye në fshat.

Pas ca kohe, e motra vuri re se plaka nisi të rrojë mirë e të prishë shumë pare. Vajti e i tha:

— Moj motër, ti po prish shumë pare e po rron mirë. Më thuaj, ku i ke gjetur këto pare?

Plaka u gjend ngushtë e ia tregoi të gjitha.

Të nesërmen, e motra u ngrit, mori një thes të madh e shkoi në mal. Të mos e zgjatim: gjeti shtëpinë dhe brenda në shtëpi gjeti dymbëdhjetë djem të rinj. Hyri brenda, tha mirë se ju gjeta e ndenji përdhe.

Djemtë e pyetën:

— Ç'të ka sjellë këtej, moj plakë?

— Kam ardhur, — u tha ajo, — për të mbledhur karthje, se ja ardhi janari, ky muaj i keq e i mallkuar. Mos e sjellte herë tjetër kokën këtej se më bën të mardh nga të ftohtit.

— Po na thuaj: cili është muaji që të pëlqen? — e pyetën djemtë.

— Asnjëri nuk më pëlqen. Të gjithë janë të këqinj. Kush mund të them se është i mirë? Shkurti i çalë apo marsi nazemadhi që na bën të djegim edhe magjet? Edhe muajt e tjerë janë të mërzitshëm, ca me shi, ca me erë e ca me të nxehtë të madhe.

Atëherë djemtë e pyetën:

— Ke ndonjë trastë, moj plakë.

— Kam, — u përgjigj plaka shumë e gëzuar dhe u zgjati thesin.

— Sille këtu.

Ata ia mbushën thesin plot me gjarpërinj nga të gjitha llojet plot me nepërka, me bolla, me zhapinj e me gjithfarë shtërpinj të tjerë që zvarriten mbi dhe. Si ia mbushën kështu, ia lidhën grykën, ia dhanë plakës e i thanë:

— Kur të vesh në shtëpi, mbyll derën e dritaret, pastaj hap thesin.

Plaka mori thesin e u kthye e gëzuar në shtëpi. Atje mbylli derën e dritaret, zgjidhi grykën e thesit. Menjëherë dualën gjarpërinjtë, nepërkat, bollat, zhapinj të gjithë shtërpinj të tjerë dhe e kafshuan gjersa e lanë të vdekur.

Unë nuk isha atje, as ju nuk ishit, kështu që po të doni besoni, po të doni mos besoni.

Mbret Trojani me veshë cjapi

Na ish një mbret që i thoshin Trojan. Ky mbret na kish veshë cjapi. Berberët e mbretërisë vinin ta rruanin me radhë e nuk ktheheshin prapë në shtëpi. Sapo e rruanin, mbreti i pyeste:

—Ç'pe këtu?

— Veshë cjapi.

Dhe atëherë mbreti i vriste.

Sot njëri, nesër tjetri, i erdhi radha një berberi plak. Ky e mori vesh se do ta vriste, u shti i sëmurë dhe dërgoi çirakun ta rruante mbretin. Mbreti e pyeti:

— Pse nuk erdhi yt zot?

Djali iu përgjigj:

— Im zot është sëmure, o mbret.

Mbreti ndenji në fron, djaloshi e rrojti. S'do mend, ai pa menjëherë se mbreti kish veshë cjapi.

Mbreti e pyeti:

— Ç'pe këtu?

— Asgjë.

Mbreti i dha dymbëdhjetë florinj e i tha që të vinte ditë për ditë ta ruante.

Djali mori paret e u kthye tek i zoti. Ky e pyeti:

— Hë, ç'pe atje?

— Asgjë. Mbreti më tha që të shkoj ta rruaj ditë për ditë.

Kështu, djali nuk e bëri për fjalë se mbreti kishte veshë cjapi. Shkoi ditë për ditë ta rruajë mbretin dhe mori ditë për ditë nga dymbëdhjetë florinj. Ai e mbajti të fshehtë e nuk i tha askujt se si i kish veshët mbreti, sot kështu, nesër kështu, u përpoq dhe e mbajti të fshehtë, po nisi të tretet, të sëmuret. I zoti e vuri re dhe nisi ta pyesë qysh e pse, po djaloshi nuk i tregoi. Më në fund u mërzit e i tha:

— Kam një të fshehtë që e mbaj në shpirt, po s'mund ta them, se kështu e kam punën.

— Thuaje, që të lehtësosh zemrën.

— Nuk e them dot, se kam frikë.

— Ma thuaj vetëm mua e do ta mbaj të fshehtë, nuk do t'ia tregoj njeriu.

Djali u mbajt e nuk ia tregoi.

— Atëherë, — i tha berberi, — në qoftë se s'ma thua dot as mua, dil në fushë, bëj një gropë, fut kokën brenda e thuaja dheut të fshehtë, pastaj mbuloje gropën me dhe, që të mos duket e mos njihet fare.

Djali bëri ashtu siç e porositi i zoti: doli në fushë, bëri një gropë, futi kokën brenda e thirri:

— Mbret Trojani ka veshë cjapi! Mbret Trojani ka veshë cjapi! Mbret Trojani ka veshë cjapi!

Me të mbaruar këtë punë, e mbuloi gropën dhe u kthye i qetë në shtëpi.

Pas ca kohe në atë vend mbiu e u rrit një shtog me tri degë të bukura e të drejta si ca shigjeta. Barinjtë prenë njërën degë dhe bënë një fyell. Mirëpo, kur i ranë këtij fyelli u dëgjuan anembanë këto fjalë:

— Mbret Trojani ka veshë cjapi!

Nuk shkoi shumë kohë dhe këtë e dëgjoi gjithë qyteti, gjithë mbretëria. Më në fund dëgjoi edhe mbreti vetë se fëmijët i binin fyellit rreth pallatit e se fyelli thosh: «Mbret Trojani ka veshë cjapi».

Dërgoi e thirri menjëherë djaloshin që e rruante. I tha:

— Kështu e mbajte ti besën? Pse vajte e ua the të gjithëve të fshehtën?

Djaloshi u mundua t'ia mbushë mendjen se nuk i kish treguar njeriu, po mbreti nuk i zuri besë, nxori shpatën e u mat t'ia presë kokën. Djali u tremb, i ra në gjunjë e ia tregoi të gjitha me radhë: se si ia tha të fshehtën dheut, se si aty u rrit një shtog, se si barinjte prenë degët e këtij shtogu për të bërë fyej dhe se si këta fyej e hapën anembanë të fshehtën. Atëherë mbreti dha urdhër t'i sillnin karrocën dhe shkoi të shohë vetë vendin tek ish rritur shtogu. Këtij i kish mbetur vetëm një degë. Mbret Trojani dha urdhër që ta prisnin e t'i bënë një fyell. Bënë ashtu siç tha. Pastaj dha urdhër që t'i bien këtij fyelli. Dhe ç'dëgjoi? Fyelli thosh: «Mbret Trojani ka veshë cja-pi»!

Mbreti u bind se asgjë nuk mund të mbahet e fshehtë në botë, ia fali jetën djalit dhe që atë ditë nuk vrau më asnjë berber.

Farkëtari trim

Ishte një baba e kishte një djalë. Ky djalë s'ishte si të tjerët, po kreshnik. Një ditë babai e mori djalin dhe e shpuri tek një këpucar, që të mësojë zanat. Mirëpo sapo e hiqte pak spangon për të qepur, e këpuste menjëherë, thyente gjilpërat. Këpucari duroi sa duroi pastaj i tha:

— Ti s'je për mua, o djalë. Spangon e këput, gjilpërat i thyen, se je shumë i fortë. Më mirë shko në një farkë që të mësosh të punosh hekurin, se farka do fuqi e hekuri është hekur.

Kështu bëri djali: shkoi të punojë te një farkëtar. Mirëpo as aty s'qëndroi dot. Ngriti

varenë e i ra kudhrës, po i ra kaq fort sa u tund tërë farka. Kudhra u fut tre pash nën dhe...

Farkëtari e shikoi i habitur, i trembur.

— Unë s'të mbaj dot, o djalë, se ti më shkatërron farkën. Mbaj dorën të të jap sa pare të duash, vetëm largohu që këtej.

Djali iu përgjigj:

— Nuk dua të më paguash asgjë. Më jep vetëm atë shul hekuri që ke aty në farkë.

Farkëtari u gëzua shumë që po shpëtonte kaq lehtë nga çiraku i fortë dhe u dha urdhër atyre gjashtë çirakëve të tjerë që të ngrinin shulin e hekurit e t'ia jepnin atij që e kërkonte. Ata të gjashtë u munduan, gulçuan, dërsitën, po nuk mundën ta ngrenë nga vendi. Atëhere djali i largoi të gjashtë, qeshi, ngriti vetë shulin e hekurit, e hodhi si shkop mbi sup, tha lamtumirë e shkoi. Me që s'kish ç'të bënte në ato vende, ai doli nëpër botë për të kërkuar fatin e tij. Eci ditë e natë një javë të tërë, la prapa një vend, pastaj edhe një vend tjetër dhe hyri në të tretin. Shko-shko, nëpër një pyll, pa një burrë që shkulte pishat me gjithë rrënjë. U bënë miq e shkuan bashkë. Udhës, kur po shkonin pranë një mulliri, panë mullisin që po loste me gurët e mullirit: i hidhte e i priste në dorë. E muarën edhe këtë e shkuan më tej.

Shkuan sa shkuan e më në fund thanë të shohin se kush nga të tre ishte më i fortë. Më i fortë do të ishte ai që do të hidhte gurin më lart. I pari e hodhi mullisi. Guri u ngrit lart e ra poshtë, pas një ore. I dyti e hodhi ai që shkulte pishat me gjithë rrënjë. Guri u ngrit lart e lart e ra prapë përdhe pas tri orësh. Më në fund i erdhi radha kreshnikut: ky e hodhi edhe më lart nga të tjerët; guri ra përdhe pas tri ditësh.

— Qënkemi të fortë, — thanë ata të tre. S'ka se kush të na mundë.

Dhe shkuan më tutje.

Një ditë, kur po shkonin pranë një pylli të dendur, panë majë një kodre një kështjellë të madhe. Hynë aty e ndenjën. Në qilaret gjetën plot të ngrëna e të pira. Ata të tre kuturisën që ditë për ditë të dilnin për gjah kurse i treti të rrinte brenda e të gatuante drekën. Kur dreka të ishte gati do të jepnin shenjë nga kulla e kështjellës: do të ngrinin një flamur.

Ditën e parë ndenji të gatuajë mullisi. Kur mbaroi punë e po bëhej gati të ngjitej në kullën e kështjellës që të ngrinte flamurin, iu afrua derës një lypsar e kërkoi lëmoshë. Mullisi doli e i zgjati një thelë mish. Lypsari e mori, po menjëherë i ra nga dora. Atëherë iu lut mullisit të ulej e ta merrte, sepse ai ishte, gjoja, plak e nuk mund të

përkulej. Mullisi u ul të marrë thelën. Në këtë kohë lypsari rrëmbeu atë shulin e hekurt të farkëtarit e ngriti dhe nisi ta godasë, bam e bum, gjersa e la të shtrirë përdhe giysmë gjallë e giysmë vdekur. Mullisi i giorë s'kish ngrënë kurrë një të rrahur të tillë. Si e la kështu, të shtrirë, lypsari u zhduk. Në këtë kohë ata dy gjahtarët i kish marrë uria. Kthenin sytë e shikonin orë e çast kështjellën, po flamuri nuk dukej. Pritën sa pritën, gjuan sa gjuan e kur u ngrys u kthyen në shtëpi të uritur. E gjetën shokun të shtrirë giysmë gjallë e giysmë vdekur. Mezi e suall në vete. ia lidhën plagët, e shtruan në shtrat. Kur hapi sytë, mullisi u tregoi shokëve se ç'kish ndodhur e ata qeshën me të madhe.

— Burrë qenke ti? Një plak lypsar paska qenë kaq i zoti sa të të lerë të shtrirë përdhe? Turp, bre!

Të nesërmen ndenji të gatujë drekën ai që shkulte pishat me gjithë rrënjë. Farkëtari shkoi vetë për gjah. Edhe atij i ndodhi ashtu siç i kish ndodhur mullisit. Lypsari e rrahu mirë e paq me shul, e la të shtrirë e krisi iku. Farkëtari gjuante e priste shenjën në majë të kullës. Priti sa pritë, i uritur, pastaj u kthye në shtëpi.

— Ama trim paske qenë edhe ti! —

— tha ai kur e pa shokun të shtrirë përdhe te pragu i derës. — Nesër e kam radhën unë të gatuj drekën. Të shohim kush do të dalë më i fortë.

U gdhi ditë. Farkëtari zuri të gatujë drekën. Sapo zjeu mishi, erdhi lypsari e kërkoi lëmoshë. Farkëtari u zemërua, megjithatë i erdhi mëshirë e i dha një thelë mish. Lypsari e mori, po aty për aty i ra nga dora e iu lut farkëtarit të ulej e t'ia jepte së dyti.

— Si the? — e pyeti farkëtari duke thirrur — kaq përtac qenke sa s'dashke të ulesh ta marrësh që përdhe?

Me të thënë kështu i ra me shul në sup dhe e shembi. Sa të hapësh e të mbyllësh sytë lypsari u zhduk, e përpiu dheu.

— Hë, kështu! — thirri farkëtari. — Që sot e tutje ky lypsar nuk do të shkelë më këtej!

Kur u shëruan të dy shokët, farkëtari i mori e shkoi të shohë vendin ku ishte zhdukur lypsari. E ç'pa atje? Një greminë të errët si nata. U tha shokëve:

— O shokë, njëri nga ne duhet të zbresë poshtë, që të shohë se ç'ka atje.

Të zbresë, po si të zbresë? Gremina s'kish fund. Dhanë e muarën gjersa kuturisën të lidhin një zile me një spango, kështu që

ai që do të zbriste poshtë ta hiqte spangon e të jepte shenjë po të shihte ndonjë rrezik. I pari zbriti mullisi. Me të zbritur nja dhjetë a pesëmbëdhjetë pash u tremb e i ra ziles. Shokët e nxorën lart. Zbriti ai që shkulte pishat, po nuk duroi dot shumë e i ra ziles. E nxorën edhe këtë. Fundi, zbriti farkëtari me gjithë shulin e hekurt. Zbrit-zbrit, arriti përpara një dere hekuri. I ra me shul dhe e hapi. Po ç'pa atje? Çudi. Atje pa botën tjetër, botën e poshtme. Ajo botë qenka më e bukur se sa bota e sipërme. Farkëtari u nis andej e arriti në një vend ku kish tri kështjella: njëra e argjendtë, tjetra e artë, e treta e xhevahirtë. Ai ndenji i shikoi një copë herë e pastaj kulturisi të hyjë në të tri kështjellat për të parë se ç'kishin brenda. Hyri në të parën. Këtë e ruante një gjarpër i madh. Gjarpër të këtillë farkëtari s'kish parë kurrë në jetën e tij. Mori shulin që mbante në sup, i ra dhe e la në vend. Hyri në kështjellë. Aty i doli përpara një vajzë e bukur, iu fal e i tha:

— O trim, ti më shpëtove. Mua më kishin rrëmbyer nga shtëpia, më kishin magjepsur e më mbanin këtu si robinjë.

Farkëtari e mori vajzën, e shpuri në të hyrë të greminës, i ra ziles e u thirri sho-

këve ta ngrinin lart. Më të ndarë, vajza nxori i dha një unazë xhevahiri e i tha se në dy kështjellat e tjera ndodheshin dy vajza të tjera të rrëmbyera e të magjepsura. Mullisi e ai që shkulte pishat hoqën litarin, e nxorën lart. Vajza u pëlqeu të dyve, sa u zunë shok me shok se sikush donte ta merrte për grua.

Në këtë kohë farkëtari futi në gisht unazën e shkoi te kështjella e dytë. Kur po bente të hynte brenda, i doli përpara një kuçedër gojëmadhe, që u mat ta përpijë. Plasi lufta. Luftë e fortë. F'arkëtari mezi mundi ta vrasë kuçedrën e hyri brenda. Aty i doli përpara një vajzë më e bukur se sa e para. Farkëtari e mori edhe këtë dhe e shpuri atje ku kish shpënë të parën. Më të ndarë, vajza i dha një shpatë të artë e i tha që të mos e përdorte, veçse kur të gjendej në rrezik të madh.

Kur e panë vajzën ata të dy lart zunë të grinden njëri me tjetrin se kush ta merrte për grua. Në këtë kohë, farkëtari me shulin në dorë e shpatën në brez, u nis e shkoi te kështjella e tretë. Mirëpo derën e kështjellës e ruante një sprijë me tri koka. Farkëtari nuk e zgjati shumë punën: mori shulin dhe i ra sprijës. Ai pandehte se do ta shembte me një të goditur, po sprija ishte

shumë e fortë, ment e përpiu. U përpoqën e luftuan shumë, gjersa sprija zuri të lodhej. Atëherë farkëtari zhveshi shpatën e artë e ia preu të tri kokat. Sprija u përpëliti sa u tund dheu.

Farkëtari hyri brenda në kështjellë. Aty i doli përpara një vajzë më e bukur nga dy të parat. Ajo ndriste ashtu siç ndrit ylli i mëngjezit, që i errëson gjithë yjtë e tjerë. Ata të dy — farkëtari trim e vajza e bukur — e shikuan një copë herë njëri tjetrin, si të magjepsur. Më në fund vajza i tha:

— O trim, ti më shpëtove jetën. Këtë të mirë nuk do të ta harroj kurrë.

Farkëtari e mori dhe e shpuri atje ku kish shpënë dy të parat. Ata që rrinin sipër hoqën litarin edhe e nxorën në botën e sipërme. Kur e panë kaq të bukur zunë të rrihen shok me shok, sepse sikush e donte për vete.

Farkëtari u bëri shenjë që ta nxirrnin, po ata të dy s'kishin nge për këtë punë: luftonin shok me shok!

Farkëtari zuri të vrasë mendjen ç'të bëjë që të dalë në botën e sipërme. Mendoi sa mendoi, pastaj kuturisi të hyjë prapë në të tri kështjellat, mbushi trastat me argjend. me ar e me xhevahirë, aq sa mund të mban-te. Papritur në kështjellën e fundit e pa atë

lypsarin plak, që ish strukur në një cep e dridhej nga frika si fleta e plepit. Farkëtari e kërcënoi me shulin e hekurit e i tha që t'i tregonte derën që nxirrte në botën e sipërme. Ai tjetri, që ishte magjistar, u tremb, nxori një çelës të madh, ia dha farkëtarit e i tregoi derën. Farkëtari i thirri me zemërim:

— Mua më tregon derën? Hape vetë, se do të të shemb me këtë shul!

Dashje pa dashje, magjistari iu afrua derës, i ra ziles. Dera u hap menjëherë. Atëhere të tri kështjellat u zhdukën, i përpiu dheu bashkë me magjistarin.

Farkëtari u tremb shumë e doli vrap nga bota e poshtme. U gjend në botën e sipërme e pa ato tri kështjellat në mes të ca luadheve të gjelbër. Fërkoi sytë e tha: «A mos shoh ëndërrr?» Iu afrua kështjellave. E ç'pa aty? Mullisi dhe ai që shkulte pishat po luftonin fyt për fyt se kush do të merrte vajzën e bukur mbi të bukurat. Kur e panë farkëtarin mbetën si të ngrirë, pastaj i ranë më gjunjë e kërkuan falje. Farkëtari i fali, po u tha se vajzat do t'i ndante vetë si të donte. Ashtu bëri. Vajzën e tretë e mbajti për vete, të parën ia dha mullisit dhe të dytën atij që shkulte pishat.

Të tria vajzat iu falën edhe një herë se i kishte shpëtuar. E treta pranoi me gëzim

që ai ta merrte për grua. Në atë çast farkë-
tari u ndryshua menjëherë e u bë një dja-
losh i bukur i veshur me rroba mëndafshi.
Tani nuk ishte më kreshnik, po as që i pël-
qente të ishte ashtu. Ashtu u ndryshua edhe
mullisi, pastaj edhe ai që shkulte pishat.

Kështu u bë njeriu urith

Ishin dy vëllezër. Ata ndanë mirë e drejt pasurinë që u kish lënë i ati, po nuk u morën vesh se si ta ndanin luadhin. I madhi donte ta mbante të tërë për vete, i vogli donte ta ndanin më dysh. Për këtë punë u grindën.

I madhi kish një djalë. E mori e i tha:

— Bir, unë do të bëj një gropë në luadh dhe do të të fut brenda të djelën e parë pas hënës së re. Do të vij aty me tim vëlla. Ky do të pyesë: «I kujt je, o luadh?», po ti nuk do të përgjigjesh. Kur të pyesë unë, «I kujt je, o luadh?», ti të përgjigjesh: «Jam yti, jam yti.»

— Mirë, — i tha djali, — ashtu do të bëj.

Pastaj vëllai i madh i vajti të voglit e i tha:

— O vëlla, ne po grindemi më kot për punën e luadhit. A di ç'të bëjmë? Të shkojmë të dielën e parë pas hënës së re dhe ta pyesim luadhin i kujt është. Si të na përgjigjet, ashtu do të bëjmë.

— Mirë, — i tha i vogli, — ashtu do të bëjmë.

Të dielën në mëngjes, pas hënës së re, i madhi e futi të birin në gropën që kish bërë në luadh. Si e vendosi atje shkoi thirri të vëllanë që të pyesin luadhin i kujt është. I vogli thirri:

— I kujt je, o luadh?

Luadhi nuk u përgjigj. Pas të voglit thirri i madhi:

— I kujt je, o luadh?

Atëherë u dëgjua një zë që u përgjigj nga dheu, poshtë:

— Jam yti, jam yti!

Kështu, luadhi i mbeti të madhit. Po kur ky vajti ta nxjerrë të birin nga gropa, nuk e gjeti më. Aty pa vetëm ca vrime urithi. Thirri gjersa u ngjir: «Dil, dil!» Po djali nuk doli. Ai ish bërë urith dhe ish futur në një vrimë. Ashtu ka mbetur edhe sot e kësaj dite: urith.

Tri këshilla për tre florinj

Një herë një njeri kish qënë në mërgim e po kthehej në shtëpi. Arriti në një fshat, trokiti në një derë e iu lut të zot të shtëpisë që ta mbante atë natë të flinte brenda. I zoti ia hapi derën. Mërgimtari hyri e nderi, i zoti i shtëpisë rrinte e nuk fliste.

— Më jep ndonjë këshillë, — i tha mërgimtari.

— Unë nuk flas po s'më dhe pare.

— Sa pare do? — e pyeti mërgimtari.

— Një flori për një këshillë, — i tha ai tjetri.

Mërgimtari nxori i dha një flori. I zoti i shtëpisë i tha:

— Lumin e turbullt mos e hidh kurrë në va, se të mbyt.

— Mirë, po më thuaj edhe një këshillë tjetër, — i tha mërgimtari plakut.

— Pa pare nuk flas, — ia ktheu prapë ky.

Mërgimtari nxori e i dha një flori tjetër.

— Udhës së Viçit mos shko, se aty ke rrezik; aty vinë rrotull shqiponja, — i tha plaku.

— Mirë, mirë, po më thuaj edhe një këshillë tjetër, — i tha mërgimtari dhe i dha edhe një flori.

— Po të shikosh ndonjë punë të keqe, — i tha plaku, — bëj durim, prit.

Të nesërmen mërgimtari u nis për udhë e arriti buzë një lumi të turbullt. Aty nde-nji e priti. Në këtë kohë na vjen një burrë kaluar mbi një kalë. E sheh njerinë që pret buzë lumit e i thotë:

— Haj të kalojmë lumin në va.

— Është shumë i turbullt, — ia ktheu mërgimtari. — Kam dhënë një flori që të mos kaloj kurrë lumë të turbullt.

Kalorësi s'priti po hyri në lumë. Uji e mori dhe e mbyti, kurse kali doli prapë në breg. Mërgimtari e zuri dhe i gjeti pesë-qind florinj në hejbet. I hipi e shkoi për në vend të tij. Udhës u kthye e ia mori për nga Follorina e që aty për nga Viçi. Andej

pa ca shqiponja që vinin rrotull sipër malit. Mërgimtari tha me vete:

— Unë dhashë një flori për një këshillë; nuk do të shkoj andej.

Dhe nuk shkoi. Kështu shpëtoi jetën, sepse andej kishin zënë udhën ca kusarë, që zhvishnin e vrisnin.

Kështu, mërgimtari arriti shëndoshë e mirë në shtëpi. Po ç'të shohë në dritare? Pa një djalosh që po fliste me të shoqen. Menjëherë nxori dyfekun që ta vrasë djaloshin. Mirëpo iu kujtua ajo fjala e plakut dhe bëri durim. Trokiti në portë.

— Hej, kush je ti? — e pyeti e shoqja nga brenda.

— Jam unë, yt shoq, — ia ktheu mërgimtari.

Gruaja ia hapi dhe ai hyri brenda, u sul drejt në dhomë.

— Cili je ti? — e pyeti mërgimtari djaloshin, që kish folur me të shoqen.

— Ky është yt bir, — i tha e shoqja. — Kur ike në mërgim ti e le të vogël e tani është njëzet vjeç.

Mërgimtari kish dhënë tre florinj për tri këshilla. Me këto tri këshilla kish fituar pesëqind florinj, kish shpëtuar nga duart e kusarëve dhe nuk e kish vrarë të birin.

Përse ska më vitore

1

Një herë një nuse e re lindi një djalë të bukur, shumë të bukur. Natën e të tre-tave erdhën vitoret dhe rrethuan djepin e foshnjës. Nëna nuk i shikonte e nuk i dëgjonte, po babai i shikonte dhe i dëgjonte. Ai e dinte se vitoret kishin ardhur t'i caktonin fatin foshnjës: jetën shëndetin dhe mjerimet. Burri rrinte në një qoshe dhe mbante vesh.

— Moj motra, — tha vitorja e parë, — tani do t'i caktojmë fatin kësaj foshnje.

— Unë, — tha e dyta, — dua t'i jap jetë të gjatë.

— Jo! — thirri e treta; — Unë dua që kur të gdhiet ditë, foshnja të vdesë.

Babai i mjerë u drodh nga frika.

— Dëgjoni! — tha përsëri vitorja e parë. — Unë them t'ia lidhim ndryshe fatin: djali të vdesë kur do t'i sjellë nënës gëzim më të madh, pra ditën kur do të nisë të flasë.

— Mua s'më pëlqen fjala jote, — ia preu e dyta. — Dua që ky djalë të vdesë në moshën kur do t'u sjellë prindërve më shumë hidhërimë.

— Unë, moj motra, — tha e treta që ishte shumë e ligë, — dua që ky djalë të rritet e të bëhet shumë i bukur, sa që bota ta quajë Ivo-bukuroshi... Dua që të martohet, të bjerë të flerë natën e parë shëndoshë e mirë, me nusen, dhe në mëngjes të gdhiet i vdekur.

— Ashtu qoftë, — thanë dy të tjerat.

2

Vitoret u zhdukën. Babai i dëgjoi të gjitha, u ngrit, puthi foshnjën dhe të shoqen, por nuk tha gjë.

Ivoja u rrit e u zbukurua. Vaizat linin kokën pas tij. Nëna desh që ta martonte dhe i thosh shpesh e më shpesh të shoqit:

— Ta martojmë Ivon tonë...

— I shoqi rrinte shumë i pikëlluar dhe përgjigjej:

— Ta lëmë për më vonë, moj Vekie e dashur. Djali është shumë i ri. Ku ta dish, ndofta e fejuara do të të bëjë të derdhësh lot.

Nëna çuditet kur dëgjon këto fjalë e nuk ia kthen të shoqit. Mirëpo Ivo-bukuroshi kërkon ta gëzojë nënën, të martohet si gjithë moshatarët e tij. I lutet babait t'i japë leje të martohet, po babai ngul këmbë: «Jo, e jo!».

— Meqë s'më jep leje të martohem, unë do të shkoj larg!

— Mirë, bir, Shko... — i thotë babai tërë helm.

3

Dhe djali u ngrit e shkoi. Ec-ec, ditë e natë, arriti në një pyll të madh ku pa një shtëpi të bardhë. Në këtë shtëpi kish një plakë.

— Mirë se të gjeta, moj nënë, — i thotë Ivua.

— Mirë se ardhe, Ivo bukuroshi, — ia kthen plaka.

Ivoja ia tregon fill e për pe brengat që e

brenin dhe i lutet plakës ta mbajë disa ditë në shtëpinë e bardhë.

— Unë të mbaj, — i thotë plaka, — jo vetëm disa ditë po tërë jetën. Kam treqind krerë dhen të zinj. Këta dhen do të shkosh t'i kullosësh në malin e parë dhe në të dytin, po kurrë nuk do t'i shpiesh në të tretin. Më dëgjon? Nuk do t'i shpiesh kurrë në të tretin!

— Mirë, — i thotë Ivo-bukuroshi.

Me të thënë kështu, merr tufën e të treqind dhenve të zinj dhe e shpie në malin e parë. Mirëpo ky mal është i thatë, i zhveshur, vetëm shkëmb e shkrep, shkretëtirë. Aty s'kanë se ç'të kullosin dhentë. Shkon në të dytin, që është i gjelbër, i veshur, plot bar të njomë, plot kronj e zogj këngëtarë. Dhentë kullosin të gëzuar, mbushin barkun, sjellin shumë qumësht, po Ivo-bukuroshi nuk ndien gëzim: ai do që të shohë malin e tretë: ç'ka atje? përse i tha plaka të mos shkelë në atë mal?

Dhe ditë për ditë plaka e këshillon që të mos shkelë kurrë në malin e tretë. Kur e dëgjon, Ivoja thotë me vete: «Kështu janë plakat: gjithnjë frikacake. Po unë do të shkoj në malin e tretë.»

Thotë kështu e një ditë vë tufën përpara dhe kapërcen cakun, hyn në malin e tretë. Aty gjen livadhe të begatshme, me bar që

i arrin gjer në brez, gjen shumë kronj e lule. Dhe gjen vajza të bukura si drita. Në fillim Ivos i duket se këto janë zana, prandaj u afrohet me shumë të druajtur. Pastaj sheh se nuk janë zana, po vajza si gjithë të tjerat. Këndon dhe vallëzon me to gjer në të ngrysur, gëzon zemrën.

4

Kur kthehet në shtëpi, plaka e merr vesh se ka shkelur në malin e tretë, sepse delet kanë më shumë qumësht. E qorton dhe i thotë të mos shkelë më andej sepse e pret vdekja. Ivoja e dëgjon, tund kokën e nuk i përgjigjet, por të nesërmen, sapo gdhihet, vë tufën përpara e shkon përsëri në malin e tretë. Aty takon ato vajzat e bukura, këndon e vallëzon siç pati kënduar e vallëzuar një ditë më parë, dehet nga gazi. Po ç'është kjo? Ivos i afrohet papritur një vajzë tjetër, e bukur mbi gjithë të bukurat, me një mollë të artë në dorë. E shikon dhe i thotë:

— Turp, Ivo! Ti po hedh valle e po këndon si i çmendur. Vallë s'je i zoti të gjesh ndonjë punë tjetër më të mirë? Qofsh i mallkuar gjersa të mos gjesh pallatin e mbret Rogoshit!

Thotë kështu zana e malit — sepse zanë

mali ishte ajo e bukura mbi të bukurat, — i hedh mollën e artë dhe bëhet erë, zhduket.

Ivoja, që një çast më parë kish qenë i lumtur, e ndien veten shumë të mjerë.

Lë prapa të tre malet e kthehet helm e vrer në shtëpinë e bardhë. Plaka, që e di se ç'e pret Ivon, qan bashkë me të.

— Bir, — i thotë ajo, — atë që fillove duhet ta mbarosh. Unë të kisha thënë mos shkelje andej e ti s'më dëgjove, tani paç zotin ndihmë e krah. Unë s'jam e zonja të bëj gjësendi. Kjo është hera e parë që po dëgjoj emrin e mbret Rogoshit. Pallatin e tij mund ta dijë vetëm nëna e diellit, sepse i biri bredh nëpër gjithë botën. Shko e fol me nënën e diellit.

5

Djali niset. Kërkon shumë-shumë kohë nënën e diellit dhe më në fund e gjen, i fallet:

— Mirë se të gjej, moj nëna e diellit!

— Mirë se erdhe, Ivo-bukuroshi. Ç'kërkon këtej, o djalë i mirë? Përse ke ardhur?

— Mos më pyet fare, moj nënë, — i thotë Ivua. Kudo që shkoj më ndjek mjerimi. Tani duhet të gjej pallatin e mbret

Rogoshit e nuk di se ku ndodhet. A nuk mund të ma rrëfesh ti udhën?

— As unë nuk e di se ku ndodhet ky mbret, po prit të kthehet im bir, dielli. Ndofta ai mund ta dijë. Vetëm fshihu gjekund, që mos të të djegë kur të të shohë.

Ivo-bukuroshi fshihet. Dielli kthehet dhe pyet:

— Ç'e keqe të shtyn këtej, o vëlla Ivo?

— Mos më pyet fare, o diell i dashur. A mund të më thuash se ku mund të gjej mbret Rogoshin?

Dhe Ivua ia tregon të gjitha brengat fill e për fill. Dielli mendohet e thotë:

— S'ia kam parë kurrë pallatin këtij mbreti. Shko të gjesh nënën e hënës dhe pyete. E bija, hëna, bredh nëpër botë ditën e natën. Ndofta ajo mund ta dijë.

Ivua shkon të kërkojë nënën e hënës. E gjen, ia thotë të gjitha... Mirëpo as hëna nuk di se ku ndodhet pallati i mbret Rogoshit, kështu që Ivua shkon te nëna e erës. Kërkon lart e poshtë dhe nuk e gjen, sepse nëna e erës nuk qëndron në një vend, po bredh anë e kënd, siç fryn era. Më në fund e gjen, i falet, i tregon brengën e i lutet që ta ndihmojë.

— Fshihu shpejt Ivo-bukuroshi, — i thotë nëna e erës. — Fshihu se ime bijë, era,

mali ishte ajo e bukura mbi të bukurat, — i hedh mollën e artë dhe bëhet erë, zhduket.

Ivoja, që një çast më parë kish qenë i lumtur, e ndien veten shumë të mjerë.

Lë prapa të tre malet e kthehet helm e vrer në shtëpinë e bardhë. Plaka, që e di se ç'e pret Ivon, qan bashkë me të.

— Bir, — i thotë ajo, — atë që fillove duhet ta mbarosh. Unë të kisha thënë mos shkelje andej e ti s'më dëgjove, tani paç zotin ndihmë e krah. Unë s'jam e zonja të bëj gjësendi. Kjo është hera e parë që po dëgjoj emrin e mbret Rogoshit. Pallatin e tij mund ta dijë vetëm nëna e diellit, sepse i biri bredh nëpër gjithë botën. Shko e fol me nënën e diellit.

5

Djali niset. Kërkon shumë-shumë kohë nënën e diellit dhe më në fund e gjen, i fallet:

— Mirë se të gjej, moj nëna e diellit!

— Mirë se erdhe, Ivo-bukuroshi. Ç'kërkon këtej, o djalë i mirë? Përse ke ardhur?

— Mos më pyet fare, moj nënë, — i thotë Ivua. Kudo që shkoj më ndjek mjerrimi. Tani duhet të gjej pallatin e mbret

Rogoshit e nuk di se ku ndodhet. A nuk mund të ma rrëfesh ti udhën?

— As unë nuk e di se ku ndodhet ky mbret, po prit të kthehet im bir, dielli. Ndofta ai mund ta dijë. Vetëm fshihu gjëkund, që mos të të djegë kur të të shohë.

Ivo-bukuroshi fshihet. Dielli kthehet dhe pyet:

— Ç'e keqe të shtyn këtej, o vëlla Ivo?

— Mos më pyet fare, o diell i dashur. A mund të më thuash se ku mund të gjej mbret Rogoshin?

Dhe Ivua ia tregon të gjitha brengat fill e për fill. Dielli mendohet e thotë:

— S'ia kam parë kurrë pallatin këtij mbreti. Shko të gjesh nënën e hënës dhe pyete. E bija, hëna, bredh nëpër botë ditën e natën. Ndofta ajo mund ta dijë.

Ivua shkon të kërkojë nënën e hënës. E gjen, ia thotë të gjitha... Mirëpo as hëna nuk di se ku ndodhet pallati i mbret Rogoshit, kështu që Ivua shkon te nëna e erës. Kërkon lart e poshtë dhe nuk e gjen, sepse nëna e erës nuk qëndron në një vend, po bredh anë e kënd, siç fryn era. Më në fund e gjen, i falet, i tregon brengën e i lutet që ta ndihmojë.

— Fshihu shpejt Ivo-bukuroshi, — i thotë nëna e erës. — Fshihu se ime bijë, era,

mund të të shembë përdhe! Ajo shpejt vjen e shpejt shkon, me gjëmë.

Në atë çast arrin era.

— Nënë, këtu mban erë njeriu. Ç'kërkon ky njeri?

Nëna mezi e qetëson të bijën dhe i tregon se ç'i ka ndodhur të gjorit Ivo. Mirëpo era është e nxituar: duhet të shkojë sa më shpejt, të fryjë nëpër botë. I thotë në të ecur e sipër:

— Kali qimeartë...

6

Si thotë kështu, era shkon larg e më larg. Nëna e erës i jep Ivos dy okë dyllë për qirinj, sepse ky duhet të kalojë një pyll shumë të errët. Në anë të këtij pylli është një livadh dhe në këtë livadh kullot një kalë qimeartë. Ivua niset, ndez qirinë prej dy okësh. Ky qiri tretet i tëri kur arrin në anë të pyllit. Aty sheh një kalë të bukur, i afrohet ngadalë, i godet thundrën me mollën e artë e i thotë:

— Rrofsh e qofsh, o kalë i mirë!

Kali e shikon i gëzuar e i përgjigjet:

— Edhe ti rrofsh e qofsh, Ivo-bukuroshi! Ç'kërkon në këto vise?

Ivoja ia rrëfen hollë e hollë të gjitha dhe i lutet t'i tregojë se ku gjendet pallati i mbret Rogoshit.

— Këtu afër, Ivo. Mirëpo e mira e së mirës është që ti të mos shkelësh andej. Në qoftë se duhet të vesh medoemos, bëmë një shalë dhe hipmë. Do të të shpie unë atje ku do ti.

Ivoja pret rripin, ia hedh kalit, i hidhet në kurriz, i qepet mirë e mirë. Kali ia merr me të katra, ikën si veriu. Sikur të mos paskej qenë kalë, po bir i nënës së erës, ai kapërcen shpejt e shpejt male, liqene, luginë të mëdha dhe, më në fund arrin përpara një pallati shumë të bukur. Ky ishte pallati i mbret Rogoshit. Aty Ivoja i zbrit kalit. Kali i thotë:

— Ivo vëlla, ty do të të presin shumë mirë, por mos u zër besë fjalëve të tyre, mos rri natën në pallat. Kur të ngryset, eja të më takosh.

7

Ivoja e falënderon kalin dhe hyn në pallat. Atij i dalin përpara shërbëtorë të shumtë, e presin si s'ka më mirë. Kalit i

bëjnë vend në quarin më të mirë të pallatit. Pastaj e marrin Ivon dhe e shpien në dhomën e madhe, ku gjendet një krevat argjendi i stolisur me gurë të kaltër e i thonë të ulet e të çlodhet. Mirëpo Ivo-ja është i pikëlluar. Ai kupton se duan t'i fshehin të bukurën, për të cilën ka bërë tërë atë udhë. Nuk ulet e nuk fle aty, po shkon prapë te kali i tij.

— Bëre shumë mirë, Ivo-bukuroshi, që erdhe këtu. Ato tri vajzat e mbretit, që janë tri vitoret, duan që ti të vdesësh, që të mos martohesh me të motrën, Milinkën, Shorti ka thënë se ato të tria do të vdesin kur do të martohet motra e tyre. Mos ki frikë: unë do të të bëj qime të artë midis qimeve të tjera të krifës sime, kështu që vitoret nuk do të të shohin.

E kështu, Ivua bëhet qime e artë: as më e gjatë, as më e shkurtër nga qimet e tjera të krifës së kalit. E kush mund ta gjejë tani? Kur u bë heshtje, të tri vitoret erdhën bashkë me nënën e tyre. Kjo i hodhi menjëherë dorën kalit dhe zuri t'i lëmojë krifën. Ment e gjeti aty brenda të gjorin Ivo, por atë çast këndoi këndesi, kështu që nëna bashkë me të tri të bijat u larguan duke mallkuar këndesin.

Ivo-bukuroshi ndenji tri ditë në pallatin e mbret Rogoshit. Tri net me radhë kali e fshehu me lloj-lloj mënyrash që ta shpëtonte nga zemërimi i vitoreve. Më në fund, këto kuptuan se Ivoja kish një mbrojtës të madh dhe ky mbrojtës do t'i vriste. Pra ia dhanë Milinkën e bukur. Por këtë e bënë me qëllim që t'ia merrnin përsëri kur ai do të gjendej larg kalit qimeartë:

Bënë dasmë të madhe. Mbret Rogoshi u dha të rinjve shumë dhurata nga thesari i tij dhe i përcolli me bujë.

Kur arrinë buzë pyllit të errët, në livadhin e kalit të bukur, Ivoja i tha lamtumirë me lot në sy, kurse Milinka e bukur e puthi në ballë. Kali u dha tri qime nga krifa e tij e artë dhe i shpuri gjer tek udha ku nëna e erës kish lënë Ivo-bukuroshin.

Kur babai plak dhe nëna plakë e panë të birin që arriti me Milinkën e bukur te ai mali i tretë, u gëzuan po dhe u pikëlluan. Mirëpo Milinka i qetësoi, sepse ajo e donte shumë Ivo-bukuroshin dhe kishte shpresë se nuk do të përmbushej e, thëna e vitoreve, të motrave. Ajo nuk ra të flerë. Ndenji të vigjilojë.

Në mes të natës arritën të tri motrat,

vitoret. Atëherë Milinka, që ato e pandehnin të fjetur, brofi më këmbë dhe luftoi me sa fuqi kish gjersa shkrepri drita e ditës. Luftoi dhe i vrau vitoret, shpëtoi të dashurin e saj.

Që atëherë nuk ka më vitore, sepse dashuria i mposhti të gjitha dhe shpëtoi njerëzinë nga e keqja.

Lauresha e mirë

Ish një herë një fshatar shumë i varfër. Kish vetëm një rrip toke që e mbillte mel. Në një çip të kësaj toke kishte një dru e në këtë dru kish bërë folenë një laureshë.

Fshatari e mbolli melin, ky mbiu, u rrit, lëshoi lule, zuri kockrra. Me kohë meli u poq, mirëpo lauresha zuri t'ia hajë çika-çika, me sqep. Ai e pa se do të mbetej pa mel e tha me mend e tij: «Duhet ta pres drurin, që të ikë lauresha e të mos ma hajë melin». Tha kështu, mori sëpatën e i vajti drurit, i ra një herë. Lauresha i foli me zë njeriu:

— Mos ma pre drurin, o njeri, se kë-

tu kam ngritur folenë. Po të mos ma presësh, unë, do të të jap ç'të duash.

Fshatari u çudit, ngriti kokën e shikoi laureshën e vogël dhe e pyeti:

— E ç'mund të më japësh ti, o zog i vogël? Ti s'ke asgjë, veçse nja dy pendë në trup.

— Ja, merre atë shkop që shëh aty pranë, — i tha lauresha, — dhe përpique tri herë për tokë, kërkoji ç'të duash e ai do të të japë.

Fshatari e mori shkopin, e përpoqi tri herë për toke e i tha:

— Shkop, nëm bukë e djathë!

Pa mbaruar mirë fjalën, i doli përpara një bukë e grynjtë, e ngrohtë, dhe një copë djathë i mirë në një pecetë të bardhë. Çuditet ai. S'i vjen t'u besojë syve të vet. Merr pastaj bukën e djathin, ha sa ngopet dhe i tepron edhe për të shoqen. Shkon pastaj në shtëpi i jep gruas copën e bukës e të djathit e ia thotë të gjitha një për një. Kjo nuk i zë besë. Atëherë fshatari e përpjek tri herë për toke shkopin e thotë:

— Shkop, dua të na shtrosh një drekë të mirë, nga ato që hanë pasanikët. Dua pula të pjekura e verë të kuqe!

Me të thënë këto fjalë, i shtrohet në sofër një drekë me të gjitha të mirat. E

ç'nuk kish aty! Pula të pjekura, verë të kuqe, ëmbëlsira! Hanë ata të dy, ngopen e bien të flenë. Të nesërmen gruaja i thotë të shoqit:

— Burrë, unë u mërzita në këtë kasolle. Dua të më bësh një shtëpi të madhe. Të mos ketë në tërë qarkun tonë shtëpi tjetër më të mirë.

Burri merr shkopin, e përpjek tri herë e thotë:

— Shkop, dua një shtëpi të madhe! Të mos ketë në tërë qarkun tonë shtëpi tjetër më të mirë!

Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, kasollja u zhduk dhe në vend të saj u ngrit një shtëpi e madhe, e bukur, me drifare të të gjera. Në tërë qarkun, s'kish shtëpi tjetër të këtillë!

Burri e gruaja u shtruan e ndenjën në këtë shtëpi një ditë, dy e më shumë, pastaj ajo i tha të shoqit:

— Ne u bëmë të pasur. Tani dua që të na nderojnë bota. Ftoje mbretin të vijë në shtëpi tonë.

Burri përpoqi «tup-tup-tup» shkopin për toke.

— Shkop, sillna mbretin në shtëpi!

Atë çast dikush trokiti në derë. Fshatari doli të shohë se kush është. Dhe ç'pa? Kish ardhur vetë mbreti!

— Kam dëgjuar, — tha mbreti, — se ti je bërë pasaniku më i madh i këtij qarku. Ja, të erdha në shtëpi që të të shoh si je e si shkon, të të bëj nder.

— Mirsardhe, o mbret! Urdhëro brenda të të gostisim!

Mbreti hyri brenda dhe u çudit: me të vërtetë shtëpia e fshatarit ishte më e bukura e tërë qarkut. Mbreti i pëlqeu.

E zonja e shtëpisë i tha:

— Urdhëro, o mbret i madh! Do të të gostisim me të gjitha të mirat. Burrë, merr shkopin e kërkoji të na shtrojë në sofër gjellët më të mira, nga ato që hanë mbretërit.

Fshatari e përpoqi, tri herë shkopin për tokë dhe aty për aty sofra u mbush me bukë të bardhë e me gjellë të mira nga ato që hanë mbretërit. Mbreti u çudit. Hëngri, piu, po në këtë kohë thosh me mendje: «Ç'të bëj që t'ia vjedh shkopin këtij fshatari?» Vrau sa vrau mendjen, po s'mundi të bëjë asgjë: s'dinte se si t'ja vidhte shkopin fshatarit. U kthye në pallat e u tha shërbëtorëve që t'i bënin një shkop si atë të fshatarit. Këtë shkop e përpoqi tri herë për tokë dhe i tha:

— Shkop, dua të më bësh një shatirvan mermeri me dy lëfyte; nga njëri lëfyt

të rrjedhë qumësht, nga tjetri të rrjedhë verë.

Po sado që e përpoqi shkopin, sado që i kërkoi shatrivan mermeri, nuk i dha asgjë. Domosdo shkopi i mbretit ishte një shkop sidokudo, nuk ishte i magjishëm si shkopi i fshatarit. Atëherë mbreti futi shkopin nën rrobat dhe shkoi prapë te fshatari, për gosti.

Burri e gruaja e pritën me nderim, i shtruan bukë e verë, gjellë të mira, hëngër bashkë. Mbreti i nxiti të pinë më shumë. Ata të dy u dehën. Kaq donte mbreti. Mori shkopin e tyre, u la të tijne dhe krisi iku.

Të nesërmen fshatari mori shkopin, e përpoqi tri herë për toke, i kërkoi për të ngrënë e për të pirë, po shkopi nuk i dha asgjë. E përpoqi edhe tri herë të tjera, pastaj edhe tri — më kot. Atëherë e mori me mend se ç'kish ndodhur, thirri me të madhe:

— Moj grua, mbreti na e paska vjedhur shkopin!

— Ç'po thua ashtu, burrë? Mbreti ynë është mbret, njeri i madh, i mirë! Ne e pritëm, e gostitëm si mundëm. Ai nuk bën gjëra të këtilla. Kushedi ç'ka ndodhur. Shko shpejt në pallat ndofta e ka marrë

pa dashje, shpjeri shkopin e tij e i thuaj të të japë tonin.

Fshatari shkoi te mbreti që të kërkonte shkopin e tij, po mbreti e priti me këmbët e para, nuk e la as t'i shkelte prakun. Thirri:

— Unë të bëra nder të erdha mysafir, që të shohë tërë bota, dhe ti më thua se të paskam vjedhur një shkop? Hej, shërbëtorë! Merreni këtë budalla e i hiqni njëqind të vala, që herë tjetër të mos guxojë të shkelë në pallatin tim.

Njerëzit e mbretit e zunë fshatarin, e shtruan përdhe, i hoqën njëqind shkopinj të mirë dhe e hodhën tutje në shesh, gjysmë të gjallë, gjysmë të vdekur. Fshatari dergjej përpara pallatit të mbretit, rënkonte, gulçonte, kërkonte ndihmë, po asnjëri nuk guxonte t'i afrohej e ta pyeste, t'i zgjatte dorën. Të gjithë ia kishin frikën mbretit, se i shtronte në dru.

Më në fund, fshatari, bëri si bëri, u ngrit e u hoq zvarrë-zvarrë në shtëpi. Doli e shoqja ta presë. Ai ia tha të gjitha.

— Mirë që shpëtove gjallë! — i tha ajo. — Mbreti s'le gjë pa bërë, të vret. Shko te lauresha dhe i kërko një shkop tjetër.

Fshatari mori sëpatën e shkon i bie drurit të laureshës.

— Ç'kërkon, o njeri i mirë? — e pyet lauresha.

Fshatari i tha se mbreti ia vodhi shkopin, se njerëzit e mbretit e shtruan e i hoqën njëqind të vala, pastaj iu lut që t'i japë një shkop tjetër.

— Unë kisha vetëm një shkop të këti-llë, o njeri, — i thotë lauresha. — Atë që kisha, ta dhashë. Tani po të fal një gomar. Sapo t'i biesh vitheve do të të nxjerrë një flori nga goja.

— Ku është ky gomar?

— Ja, atje, nën atë dru. Merre dhe udhembarë.

Fshatari hedh sytë përçark dhe sheh nën një dru një gomar të përhimë.

I hip e shkon në shtëpi. Me të hyrë në oborr, i thërret së shoqes:

— Dil, grua të shikosh se ç'gomar të kam sjellë!

Gruaja doli te praku, e pa gomarin e nisi ta qërtojë të shoqin:

— O derëzi, unë s'të dërgova për gomar, po për shkop!

— Prit, moj grua, ti s'di gjë. Ky gomar s'është si të tjerët. Pa shiko se ç'do të bëjë tani!

I ra me shkop vitheve edhe gomari i nxori nga goja një flori. I ra edhe një he-

rë — i nxori një flori tjetër. Sa herë që i binte, gomari nxirrte nga një flori.

Fshatari me të shoqen zunë të rrojnë mirë, të hanë e të pinë ç'të duan. Por e keqja u erdhi nga s'e pandehnin. Një ditë fshatari i hipi gomarit e shkoi në treg. Kur u gjend pranë dyqanit të nallbanit, tha me mendje: «S'do të ish keq ta mbathja gomarin». Të thënë e të bërë: hyri te nallbani, e mbathi. Si mbaroi punë i ra gomarit vitheve edhe ky nxori një flori nga goja. Këtë flori ia dha nallbanit për punën që kish bërë e shkoi të hajë bukë. Gomarin e lidhi në oborr, vetë hyri në pijetore. Hëngri e piu mirë e mirë. Po ç'bëri nallbani? Mori gomarin e tij, e lidhi në oborr të pijetores, kurse gomarin e fshatarit e mori dhe e shpuri në shtëpi të tij.

Në të ngrysur fshatari u kthye në shtëpi, i lodhur. E shoqja, sapo e pa e njohu se gomari s'ish i tyre. Zuri ta qërtojë të shoqin:

— Ç'ke bërë kështu, burrë? Prapë të gënjyen!

— Kush më gënjeu!

— Nuk sheh se gomari s'është yni?

Ai s'i zuri besë, i ra gomarit vitheve, po gomari jo që s'i nxori flori, po edhe i ra me shqelm, sa ment ia theu dhëmbët.

Fshatari u bë pik e vrer. Mori prapë

sëpatën e i vajti drurit, zuri t'i bjerë. Lauresha i thotë:

— Ç'kërkon, o njeri i mirë?

— Më ka ndodhur një e keqe e madhe: ma vodhën gomarin, — përgjigjet fshatari e mënt qan.

— Mos u hidhëro, o njeri i mirë, — i thotë lauresha. — Ja në atë dardhë është varur një çekan hekuri. Bjeri me këtë çekan tokës tri herë dhe do të të dalin përpara tre trima të mëdhenj. Jepu urdhër dhe ata do të bëjnë ç'të duash ti. Kur të mbarojnë punë, përpique prapë tri herë çekanin për toke dhe trimat do të zhduken.

Fshatari u gëzua, mori çekanin dhe shkoi drejt te mbreti. Mbreti sapo e pa u dha urdhër shërbëtorëve ta shtronin e t'i jepnin njëqind të vala, pastaj ta hidhnin në rrugë. Mirëpo fshatari «tuk-tuk-tuk» i ra tri herë çekanit. Menjëherë dual tre trima të mëdhenj që iu turrën mbretit dhe shërbëtorëve të mbretit, i rrahën mirë e paq, ua zbutën kurrizin. Mbreti u tremb e tha:

— Mbaj dorën, vëlla! Bëju urdhër trimave të mos më vrasin. Do të të jap ç'të duash.

Fshatari qeshi.

— Aha! Tani po më thua vëlla. Nëm shkopin që më vodhe e thyej qafën!

Mbreti s'kish ç'të bënte, i dha shkopin.
Fshatari e mori e shkoi në shtëpi. I vajti
pastaj nallbanit, i lëshoi trimat që e shtruan
në dru, ia mori gomarin.

Pastaj rroi e trashëgoi.

Ariu, derri e dhelpra

Ariu, derri e dhelpra u bënë miq e u lidhën bashkë të lërojnë një copë tokë dhe të mbjellin grurë. Si kuturisën kështu, zunë të bisedojnë se ç'punë duhej të bënte sikush nga të tre.

— Unë, — tha derri, — do të shkoj në lëmë të vjedh ca grurë e pastaj do ta lëroj arën me feçkë, ta bëj gati për të mbjellë.

— Unë do ta mbjell, — tha ariu.

— Unë do ta lesoj me bisht, — tha dhelpra.

Kështu bënë: lëruan, mbollën, lesuan. Ardhi koha e të korrave. Përsëri zunë të bisedojnë se ç'punë do të bëjë secili.

— Unë do të korr, — tha derri.

— Unë do të lidh duajt, — tha ariu.

— Unë do të mbledh kalinjtë që kanë rënë përdhe, — tha dhelpira.

E korrën grurin, lidhën duajt dhe zunë të bisedojnë se si ta shijnë.

— Unë do të sheshoj e pastroj lëmin, — tha derri.

— Unë do të siell duajt e do t'i shij, — tha ariu.

— Unë do t'i shkund duajt e do t'i ndaj nga kashta, — tha derri.

— Unë do ta pastroj drithin me bisht e do të largoj bykun, — tha dhelpira.

— Unë do ta hedh grurin në erë, — tha derri.

— Unë do të ndaj drithin, — tha ariu.

Kështu bënë. Si mbaruan punë, zunë të ndajnë drithin. Ndarjen e bëri ariu, po e bëri të shtrembër: drithin e mbajti për vete, derri i dha kashtën, dhelpirës nuk i dha asgjë. Dhelpira u zemërua e tha se do të shkonte në pallat të mbretit të sillte një njeri të mbretërisë që të ndante drejt drithin. Derri e ariu u trembën kur dëgjuan se do të vinte një njeri i tillë. Ata vendosën të fshihen.

Ariu tha:

— Ti, derr, futu në kashtë; unë do të ngjitem lart në dardhë që të ruaj.

Ashtu bënë. Në këtë mes dhelpira shkoi të sjellë një njeri nga pallati i mbretit. Njeri nuk gjeti, po gjeti një mace e i tha të vinte në lëmë që të zinte minj. Macja u gëzua: ajo e dinte se në lëmë kish shumë minj. U nisën ato të dyja, dhelpira e macja, për në lëmë. Udhës macja vraponte në të djethtë e në të mëngjër, kërcente përpjetë për të zënë zogj. Ariu e pa nga dardha e i thirri derrit:

— Mjerë ne të mjerët, o derr! Po vjen një bishë e tmerrshme që s'e kam parë kurrrë. I ngjet kunës¹⁾, po është shumë më e keqe: kërcen përpjetë e i kap zogjtë në fluturim.

Pastaj ariu nuk e pa më macen. Në këtë kohë kjo i qe afruar ngadalë lëmit e po kërkonte minj nëpër kashtë. Derri ngriti feçkën dhe e nxori jashtë: donte të nuhaste e të shihte se ç'kafshë ishte kjo që i tha ariu. Macja pandehu se feçka ishte mi, u vërvit e i futi thonjtë. Derrit i dhembti, hungroi, kërcëu e iku me vrap gjersa u shemb në një përrua. Macja u tremb e iu qep dardhës, atje ku ishte stru-

1) kunadhe, sqarth.

kur ariu. Ky pandehu se macja e kish vrarë
derrin e tani i kish ardhur radha atij. U
shkëput e u shemb poshtë, theu kokën e
këmbët.

Kështu, dhelpra mori gjithë grurin e
gjithë kashtën.

Dyert e të mëdhenjve

Ish mos na ish.

Ish një herë një plak që kish një rrënjë molle. Kjo rrënjë molle bënte kokrra dy herë në mot. Një ditë janari mbreti shkoi aty afër dhe e pa plakun që rrinte nën mollë dhe ruante. Plaku nuk e njohu, sepse mbreti ish veshur si gjithë njerëzit e tjerë.

— Ç'bën aty, o plak? — pyeti mbreti.

— Ruaj mollët, — iu përgjigj plakun.

— E si u bëkan mollë në janar?

— Bëhen, bëhen, — i tha plakun dhe këputi e i dha mbretit disa mollë të mira.

Atëherë mbreti nxori dhe i dha në

dorë një shkresë dhe e porositi që të vinte të nesërmen ta takonte në shtëpinë më të madhe të qytetit. Tha kështu e shkoi.

Të nesërmen, plaku mori shkresën e shkoi në pallat të mbretit sepse pallati ishte ndërtesa më e madhe e qytetit. Kur arriti atje, roja e parë që takoi e shtyu tutje, sepse e pa të veshur me zhele e tërë baltë. Mirëpo plaku i tregoi shkresën, kështu që fundi i fundit roja e la të hyjë brenda. Të mos e zgjatim, kështu ia punoi edhe ushtari i dytë, pastaj edhe i treti. Kur arriti tek ushtari i fundit, që bënte roje te dera e dhomës së mbretit, ky nisi ta shajë, pastaj e goditi, sepse kish përlyer shkallët me opingat e tij tërë baltë. Plaku i gjorë u largua shumë i tronditur. Mirëpo mbreti, kur u zgjua nga gjumi, pyeti njerëzit e tij në kish ardhur një fshatar plak në pallat. I thanë se kish ardhur, po e kishin dëbuar. Mbreti u zemërua shumë dhe dërgoi njerëz ta kërkonin e ta sillnin. Plaku nuk desh të kthehej në pallat. Mezi ia mbushën mendjen dhe e shpunë te mbreti.

Sapo e pa mbreti e ftoi të ulej poshtë, pastaj i dha një pusullë që t'ia shpinte arkëtarit dhe të merrte njëqind florinj. Kur doli nga dhoma e mbretit, fshatari e humbi toruan e zuri të bredhë nëpër koridoret, duke trokitur nga një derë tek tje-

tra. Kudo që trokiste rojet e shtynin tutje, sepse e shihnin të veshur me zhele. Më në fund, pas shumë mundimesh, arriti te arkëtari që i numëroi njëqind florinjte.

Si mori florinjtë, plaku i tha arkëtarit:

— Më jep, të lutem, një copë letër dhe një penë, sepse dua të shkruaj nja dy fjalë.

— Ç'kërkon të shkruash? — e pyeti arkëtari.

— Dua t'i porosis fëmijët e mi që të mos hyjnë kurrë në dyer të mëdha, as ata vetë, as fëmijët e tyre dhe as fëmijët e fëmijëve.

Unë s'isha atje, as ju nuk ishit atje, po këto duhet t'i besoni.

Misuri i mrekullueshëm

Po të mos kish gjetur e ëma flokëthinjur e Qelogllanit pesë grosh udhës, nuk do të kish ndodhur asgjë nga këto që ndodhën sepse po të mos i kish gjetur këta pesë grosh, nëna e djali nuk do të kishin humbur qetësinë, gjumin! Ashtu, po si është e mundur që njeriu i varfër të mos përkulet përdhe e të mos marrë një pare të ndritur? Kjo është punë që s'bëhet.

Plaka i shpuri të pesë groshët në shtëpi. Qelogllani u gëzua shumë. E ëma ishte shumë plakë, se po të mos kish qenë kështu do që ngritur të hidhte valle nga gëzimi. Mirëpo gëzimi shkon shpejt. Nëna e

djali s'dinin ç'të bënin me këta pesë grosh, prandaj zunë të grinden. Njëri thosh të blinin këtë, tjetri thosh të blinin atë, edhe s'merreshin vesh bashkë.

Qelogllani dhe e ëma s'kishin vënë gjë në gojë tërë ditën e ditës. Megjithatë asnjëri s'tha të blinin simite të buta, të ngrohta e të mbushnin barkun. Harruan fare edhe urinë, edhe gjumin. E ç'gjëra nuk u shkuan në mendje duke mbajtur në dorë ata pesë grosh! Qelogllani thosh të blinin një kalë. Nëna s'donte.

— Më mirë të blejmë një gomar! — thosh ajo. — Unë nuk i hipi dot kalit!

Atëhere Qelogllani tha se duhej të blinin një gomar mashkull. Atij i pëlqente të dëgjonte ndonjë këngë të bukur dhe vetëm gomari mund të këndonte një këngë të këstillë. Tha:

— Kur do ta dëgjoj gomarin të pëllasë, do të më bëhet zemra mal.

E ëma u zemërua:

— Jo, jo! Më mirë të blejmë një gomaricë që të na pjellë ca kërricë e të bëhemi të pasur.

Por të birit i pëlqente shumë kënga prandaj nguli këmbë:

— Unë them të blemë një fyell. Unë do t'i bie, ti do të dëgjosh.

Mirëpo nëna e ktheu mendjen e tani

donte të blinte ndonjë ngastër të mirë
toke...

U grindën sa u grindën e më në fund
iu mbush mendja të dyve se me pesë
grosh s'mund të blesh as gomar, as goma-
ricë, as shtëpi as tokë, as fyell...

Ndërkaq u ngrys e u bë natë. Lart në
qiell xixëlluan yjet, hëna i verboi të gjithë
me dritën e saj të bardhë.

Nata sjell gjumin, kështu që nëna e
djali ranë të flenë. Në mëngjes kujtuan fja-
lët që kishin thënë natën, qeshën me të ma-
dhe e kuturisën të blejnë një grip për të
zënë peshk. Me këtë grip Qelogllani shkoi
në breg të lumit. Ditë për ditë gjuante tre
a katër peshq e i nxirrte në treg. Për një
peshk i jepnin një a dy grosh, për dy peshq
i jepnin pesë grosh, për tre i jepnin shta-
të-tetë grosh. Me këto pare Qelogllani bli-
nte bukë, djathë, hallvë. Nëna e djali ha-
nin e pinin, çlodheshin, bënë jetë për
kokën e jetës. Gëzoheshin se u kish rënë
në mend të blinin një grip me ata pesë
groshët e gjetur udhës.

Një ditë prej ditësh Qelogllani zuri një
peshk të madh dhe ky peshk i bëri të hu-
mbasin përsëri gëzimin që kishin pasur.
Peshku ishte shumë i bukur, po Qelogllani
nuk u gëzua. Ai ishte i lodhur, i dhimbte
zemra. E si të mos i dhimbte, të gjorit!

Kundruall shtëpisë së tij gjendej pallati i mbretit edhe nga dritarja e këtij pallati shikonte e bija e mbretit që kur gdhihej e gjersa ngrysej. Vajza qeshte ngaherë, bënte shaka, i hidhte Qelogllanit ëmbëlsira, e trulloste fare.

Qelogllani e mori peshkun edhe e nxori në treg. U mblodhën përreth shumë njerëz që preknin me dorë luspat e thërrisnin të habitur: «Ah, ç'peshk i mirë!» Të këtillë peshk s'kemi parë kurrë! Luspat i ka të arta!» Për këtë peshk i dhanë njëzet e pesë grosh. Qelogllani u zemërua e po i shikonte me inat myshterinjtë. Një ditë më parë ai kish sjellë në treg katër peshq dhe askush nuk i kish dhënë më shumë se dhjetë grosh. Tani dukej sikur njerëzit talle-shin. Mirëpo myshterinjtë thoshin ndryshe: «Ndofta njëzet e pesë grosh janë pak, prandaj na u zemërua Qelogllani».

Njeri u hodh e tha:

— Unë të jap tridhjetë grosh.

Tjetri ia preu:

— Unë të jap pesëdhjetë grosh!

I treti:

— Të japë shtatëdhjetë grosh.

Më në fund, i katërti:

— Nëma peshkun mua, se do të të jap një lirë!

Atëherë Qelogllani u nxeh shumë e më

shumë. Mori peshkun e shkoi në shtëpi.
Aty mezi e mori veten.

E ëma e pyeti:

— Ç'të ka ndodhur? Pse je nxehur kë-shtu? Pse s'e shite peshkun?

Djali u vrenjt:

— Njerëzit qeshin e tallen me mua. Njëri tha se peshku bën tridhjetë grosh, tjetri e ngriti pesëdhjetë, një tjetër e bëri shtatëdhjetë. Po të kish dalë ndonjë të më jepte njëqind grosh, do t'ia kisha dhënë.

— Sa të dha i fundit? e pyeti e ëma.

— Një lirë...

— Po një lirë bën tamam njëqind grosh, djalë...

Pastaj nëna vuri buzën në gas:

— Ky peshk qenka me të vërtetë shumë i bukur; njerëzit nuk të qeshën e nuk të tallën. Do të kish qenë mirë ta kishe shitur e të mos e prishje gjakun më kot.

Qelogllani përpoqi këmbën e thirri:

— Jo, ata qeshën me mua!

— Mirë, qoftë ashtu si thua ti. Me që nuk e shite, do ta hamë vetë. Shko laje në lumë e sille ta pjek.

Qelogllani mori peshkun e shkoi në lumë. Më parë ia pastroi luspat, pastaj ia preu kokën e ia çau barkun. Po ç'na ndodhi? Brenda në bark gjeti një misur të gjelbër, sepse kish zënë shumë barishta të vogla

nga ato të lumit. Qelogllani e pastroi; ia hoqi barishtat. Atëherë misuri vetëtiu e ia verboi sytë. Qelogllani s'po merrte vesh asgjë. Misuri i vogël vetëtinte, shkëlqente si zjarr. A mos qe i artë? A mos qe i magjepsur? Qelogllani s'dinte ç'të bënte: e hodhi misurin në ujë. Menjëherë uji që hyri në misur u bë flori. Ky flori u derdh në fund të lumit. Qelogllani mënt humbi mendjen. E mori misurin, e mbushi me ujë dhe e derdhi këtë ujë në tokë. Menjëherë uji u bë flori. Nga gëzimi, Qelogllani harroi çdo gjë në botë. E mbushi edhe e zbrazti misurin shumë herë gjersa përpara tij u bë një tog i madh me florinj. Papritur dikush i preku supet. Qelogllani ngriti kokën, e ç'pa? Pranë tij rrinte e bija e mbretit e veshur me kadife e mëndafsh. Qeshte. Oh, sa bukur qeshte!

— Nëma mua misurin! — i tha e bija e mbretit.

Qelogllani nuk iu përgjigj, po vetëm e shikoi çupën drejt në sy.

— Do të ma japësh misurin? — i tha së dyti e bija e mbretit. — Po të ma japësh jam gati të bëj ç'të duash ti, të vij me ty kudo që të më shpiesh.

Qelogllani rrinte i heshtur. Pas pak ardhni në vete.

«Sa çudi, sa çudi, — thosh me mendje

Qeloglani. — Sot në mëngjes e bija e mbretit tallej me mua, më hidhte ëmbëlsira nga dritarja. Tani kjo bukuroshe është gati të më bjerë në gjunjë. Këtë çudi nuk e kuptoj dot, më duket sikur jam nëpër gjumë.»

— Jam gati të bëj ç'të duash ti, — tha edhe një herë e bija e mbretit.

Papritur Qeloglani vuri buzën në gaz dhe pastaj i nxori gjuhën së bijës së mbretit të madh. Futi misurin në gji e tha:

— Eja me mua!

Qeloglani shkon me nxitim. Vajza mezi e ndjek. Kalojnë nëpër rrugë e rrugica. Njerëzit i shikojnë të habitur. Edhe kanë përse të habiten! E bija e mbretit e ndjek Qelogllanin e varfër siç e ndjek qeni të zotin! Asnjeri s'merr vesh se ç'po bëhet kështu. Mirëpo Qeloglani dhe e bija e mbretit nuk venë re se njerëzit i shikojnë të çuditur. Pas pak gjenden në anë të qytetit. Vajza thotë me mendje se Qeloglani do ta shpjerë në ndonjë vend tjetër edhe atje do të martohen të dy. Ajo kishte shumë kohë që e donte Qelogllanin. Mirëpo djali ishte budalla e s'dinte gjë. Qeloglani qëndron nën një dru e shtrihet në bar. Pastaj nxjerr nga gjiri misurin e magjepsur. E bija e mbretit i thotë edhe një herë:

— Nëm misurin e jam gati të bëj ç'të duash.

— Nuk dua gjë tjetër, — i thotë Qeloggllani, — veçse të bësh kollo-tumba gjersa unë të them «mjaft». Atëherë do të të jap misurin.

E bija e mbretit shikon fustanin që ka veshur: i vjen keq ta lerosë. Po ajo do të fitojë misurin që e bën ujin flori! Për këtë misur është gati të bëjë ç't'i thonë. Çupa nuk vret mendjen shumë, vë duart përdhe e ze të bëjë kollo-tumba. Rrotullohet kaq bukur sikur të paskej qenë bijë e ndonjërit nga ata që lozin në litar. Si bën disa herë kollo-tumba, e bija e mbretit shtrihet në tokë në mes të pluhurit. Është mbytur në djersë. Pluhuri e rëra që i janë ngjitur në fytyrë janë bërë baltë. Leshrat i janë shpupuritur, i bien faqeve. Kështu siç ishte, e bija e mbretit i ngjante tani një lëmshi të artë.

Po Qeloggllani ç'bën? Qesh, përpjek duart, përplas këmbët, mban barkun me dorë nga gazi, gajas së qeshuri. Më në fund Qeloggllani i thotë çupës:

— Mjaft. Merre misurin. Tani është yti!

E bija e mbretit hodhi valle nga gëzimi, mori misurin e shkoi në shtëpi. Udhës thosh me mendje: «Sa i çudiçëm paska qenë Qeloggllani! Edhe shakatar, edhe bujar, po budalla. Tani e marr vesh përse të varfërit mbeten gjithnjë të varfër».

Megjithatë çupës i vënte keq që djali ia kish dhënë kaq lehtë misurin e nuk i kish kërkuar asgjë. Po e vërteta është se pikëllimi nuk zgjati shumë. Tani ajo e kishte në dorë misurin e artë dhe mund të bënte ç'të donte. E bija e mbretit ishte kaq e lumtur sikur të paskej hyrë brenda në parajsë.

Kur iu afrua pallatit këmbët iu prenë menjëherë. Njerëzit e kishin parë me Qeloggllanin dhe ia kishin shpënë fjalën mbretit. Domosdo, ata kishin shtuar edhe shumë të paqëna. Mbreti u zemërua shumë. Theu pesë dyer, theu dy dritare, pesëdhjetë pjata, shtatëdhjetë kupa, ua preu kokën dy vezirëve, tre pashallarëve, dyzet oficerëve, pesëdhjetë ushtarëve. Megjithatë zemërimi i zjente, i zjente. Menjëherë kuturisi t'ia presë kokën edhe të bijës. Thirri xhelatin. Ky e mori çupën e shpuri majë një mali dhe zuri të mprehë thikën.

Xhelati kish prerë shumë koka. Ai s'e kish për gjë të vriste një njeri. Po kur pa sytë e pikëlluar të kësaj vajze, i erdhi keq, iu drodh dora, iu njomën sytë.

— Moj sulltane e vogël, unë dua të të vras e nuk të vras dot. Nëm fjalën se nuk do të kthehesh kurrë në shtëpi edhe unë do të ta fal jetën.

Kështu tha xhelati, fshiu lotët e shtoi:

— Tani dua të të them edhe një fjalë, po kam turp... Dua të më japësh këmishën tënde... Jo, mos të të shkojë mendja për të keq. Këtë këmishë nuk e dua as për vete, as për time bijë. Do ta nulloj me gjak e do t'ia shpie babait tënd që të shohë se urdhri vajti në vend. Ndryshe nuk do të më besojë.

Vajza u fsheh prapa një shkëmbi, zhveshi këmishën e ia dha xhelatit. Pastaj i tha lamtumirë dhe u nis bashkë me misurin e artë. Shkoi e shkoi maleve. Edhe Qelogllani bridhte maleve, por kjo botë qenka e madhe, kështu që nuk u takuan.

I gjori Qelogllan e kish humbur mendjen. Po të mos e kish humbur, nuk do t'ia kish dhënë misurin së bijës së mbretit! Shkonte e thosh me vete:

— Oh, misur, misur!

Kaluan shumë vjet, Qelogllani bridhte maleve e nuk e harronte dot misurin e artë.

Po ç'bëri e bija e mbretit? Arriti në një qytet të madh, të bukur. Doli buzë një lumi ku s'kish njerëz, mbushi misurin me ujë, e zbrazi një herë, dy, dhjetë. Mblodhi shumë florinj. Pastaj? E para nga të parat bleu një këmishë dhe porositi një palë rroba burri. I veshi këto edhe u duk si burrë. Pastaj ndërtoi një pallat të madh, mori

shumë shërbëtorë, i veshi me petka mëndafshi të qëndisura me ar dhe argjënd. Ata që banonin në atë qytet u bënë së shpejti të pasur. Fëmijët e të varfërve loznin me florinj. Kjo s'duhet të na çudisë, sepse për pesë grosh e bija e mbretit jepte pesë florinj. Të varfërve u jepte pare me grushte. Megjithatë florinjte nuk mbaroheshin. Natën, kur të gjithë njerëzit flinin, e bija e mbretit shkonte te shatrivani, e mbushte misurin me ujë dhe bënte florinj. Askush nuk e dinte këtë të fshehtë. Njerëzit thoshin të çuditur: «Pasuri e këtillë s'është parë kurrë në botë!»

U hap fjala në gjithë vendin se kështu e kështu në aksh qytet ka dalë një njeri shumë i pasur. Pastaj kjo fjalë u hap edhe nëpër mbretëritë e tjera. Zunë të vijnë mbretër të mëdhenj e të vegjël dhe të gjithë donin ta bënin dhëndër (thamë: e bija e mbretit ish veshur si burrë), t'i jepnin çupat. Ata nuk e dinin se ajo ishte vajzë! Mirëpo pasaniku s'donte të martohej. Një ditë dëgjoi se do të vinte edhe i ati. Ajo u gëzua shumë. Dha urdhër të shtronin një gosti nga më të mirat dhe pastaj ndenji të presë.

Dhe ja, erdhi mbreti bashkë me të vëllanë e me vezirët. Të gjithë ishin veshur me rroba të bukura e mbaheshin më të

madh. Po kur shkelën në pallat, menjëherë ulën kryet se ua verboi sytë bukuria. Aty mbreti pa një shërbëtor që rrinte në shkallaren e parë edhe i pëshpëriti atij që i shoqëronte:

— Ky është pasaniku juaj?

— Jo, ky është shërbëtori i parë i katit të poshtëm.

Mysafirët u ngjitën më lart. Aty panë në një shkallë mermeri një djalosh tjetër të veshur me një palë rroba të ndritura. Mbreti e pyeti atë që e shoqëronte:

Ky është pasaniku?

— Jo, ky është shërbëtori i parë i katit të mesëm. Zoti ynë ju pret lart.

Më në fund mbreti me gjithë të tijtë arritën në katin e sipërm. Aty ndenjën pak gjersa doli vetë pasaniku që i priti i gëzuar, i pyeti si ishin nga shëndeti, pastaj biseduan, qeshën, dëfryen. Dreka ishte kaq e shijshme sa që mbreti s'u mbajti dot edhe lëpiu gishtërinjtë. U ngop shpejt, po prapë hante e hante. Thuaj se ja, tani do t'i pëciste barku. Atëherë pasaniku nxori misurin, e mbushi me ujë. Uji u bë flori. E mbushi edhe një herë me ujë, prapë u bë flori. Mbretit mënt i kërcyen sytë e ballit. Luga i ra nga dora, pushoi së ngrëni. Pasaniku i mblodhi floringjtë e ia dha mbretit.

— Merri, o padishah, t'i kam falur!

Mbreti e falënderoi pasanikun, numëroi florinjtë, ia dha në dorë vezirit e i tha që t'ia kthente kur të sosnin në shtëpi. Aty për aty shpirti iu ndez furrë që të shtinte në dorë misurin e mrekullueshëm. Iu afrua djaloshit e iu lut me zë të butë:

— Falma mua këtë misur e do të të jap ç'të duash. Vetëm kërko.

Pasaniku vuri buzën në gaz.

— S'ka gjë më të shtrenjtë se sa ky misur. Ti e sheh se ky e bën ujin flori.

— Mbreti i tregoi kurorën e mbretërisë:

— E do këtë?

— Jo, kurora është jotja, mbaje. Ne ta bëjmë me fjalë kështu: kush do të bëjë më shumë kollotumba, do ta fitojë misurin.

Mbreti zuri kokën me dorë. Ai ishte shumë i trashë dhe, veç kësaj, kish ngrënë shumë më drekë, plëncin e kish dinga! Kish frikë se misurin do ta fitonte ndonjë nga vezirët. Ç'të bënte? Papritur e mblo-dhi mëndjen e tha:

«Mirë, le ta fitojë misurin ndonjë nga njerëzit e mi, pa, kur të kthehem në shtëpi unë do t'ia pres kokën e do t'ia marr misurin.»

Me të thënë këto fjalë, u kthye e dha urdhër:

— Hajt, vezirë, t'ia fillojmë!

Dhe ia filluan. Vdisje gazit të shikoje se si bënin kollotumba mbreti bashkë me njerëzit e tij. Të gjithë ishin pleq, të gjithë ishin të trashë, të gjithë e kishin barkun plot. Mysafirët binin njëri mbi tjetrin, murmurisnin, dërsinin. U dridheshin duart, u dridheshin këmbët... Po asnjë nuk ndalej, të gjithë përpiqeshin. Ndërsa këta bënin kollotumba, e bija e mbretit doli pak nga dhoma, veshi rrobat që mbante kur braktisi pallatin e babait, kreu leshrat ashtu siç i krihte në atë kohë dhe hyri prapë në dhomë. Mysafirët bënin e bënin kollotumba. Të dukej sikur ja tani do të pëlcisnin në vend. Çupa iu afrua mbretit, e zuri për dore, e ngriti edhe i tha:

— Mjaft, baba. Për një misur ti ment po vdes.

Mbreti e njohu të bijën, e përqafoi, e shtrëngoi në krahuar:

— Lavdi pastë allahu! Ti qenke gjallë dhe mund të të shikoj përsëri.

Çupa bëri buzën në gaz, ia lëmoi mjekrën babait.

Pastaj u kthye, tregoi me dorë njerëzit e tij e tha:

— Një herë e një kohë unë kështu e fitova këtë misur, me kollotumba. Ti dhe

urdhër të ma prisnin kokën. Tani merre dhe shko, e fitove.

Mbreti doli i heshtur, kokëvarur. Mblo-dhi njërëzit e tij dhe u largua. Nuk u kthye më. E bija as që e priste. Ajo priste vetëm Qelogllanin!

Dërgoi lajmëtarët në të katër anët e botës që ta gjenin. Pas shtatë vjet e gjetën dhe ia suallën së bijës të mbretit. Kur e pa Qelogllani misurin e artë, mendja i erdhi menjëherë në vend. U martuan e rrojtën të lumtur.

Që kur kanë zënë njerëzit
të mos vrasin pleqtë,
po t'i lenë të vdesin vetiu

Thonë se në kohrat e moçme njerëzit
ishin jetëgjatë e nuk vdisnin vetiu, po i
vrisnin të rinjtë, që të mos hanin bukën më
kot. Në atë kohë na ishte një djalë që gë-
zohej se i ati ishte jetëgjatë e shëndoshë
e mirë. Ai nuk donte ta vriste, siç bënin
të tjerët, po e mbante me të gjitha të mirat.
E kish fshehur në shtëpi dhe e ushqente,
e nderonte. Një herë, të parët e atij vendi
vendosën të zgjedhin një gjykatës. Ata tha-
në se do të zgjedhin atë që do të shohë i
pari diellin kur do të lindë. Djali u kthye
e i tha babait:

— Baba, nesër të parët e vendit do të mbliidhen të zgjedhin një gjykatës. Gjykatës do të bëhet ai që do të shohë i pari diellin në të lindur e sipër.

Plaku e këshilloi:

— Bir i dashur, shko edhe ti atje ku do të zgjidhet gjykatësi, po qëndro me shpinën të kthyer nga lindja dhe shiko në anën tjetër malin më të lartë. Ti do ta shohësh i pari diellin kur do të lindë.

Djali e dëgjoi babanë dhe shkoi të nesërmen te vendi ku do të zgjidhej gjykatësi. Të gjithë rrinin me sytë nga ana ku do të dilte dielli, kurse djali kish kthyer shpinën dhe shikonte në anën tjetër, majën e malit më të lartë. Njerëzit e vunë re këtë gjë dhe zunë të flasin midis tyre.

— Shikoni se ç'po bën ky budalla... I ka kthyer shpinën vendit nga lind dielli e shikon andej ku perëndon.

Djali dëgjoi, po s'tha gjë. Pas pak thirrri:

— Ja, vështroni! Shkrepi dielli majë malit!

Njerëzit kthyen sytë andej, e panë diellin, u çuditën dhe e pyetën djalin e plakut:

— Kush të mësoi të rrish kështu dhe ta shikosh i pari diellin kur lind?

— Më mësoi im atë, që është plak njeri,
— u përgjegj ai.

Të parët e vendit i thanë:

— Po të duash të bëhesh gjykatës,
duhet të vish nesër këtu as z bathur as
mbathur, as më këmbë as kaluar!

Djali u kthye në shtëpi e ia tregoi të
gjitha babait. Ky i tha:

— Merr çizmet e pre me thikë pjesën
e poshtme ku futen këmbët. Qafat e çiz-
meve mbathi gjer në kërcinj. Kështu nuk
do të jesh as z bathur as mbathur. Pastaj
hipi një cjapi, po këmbët tërhiqi zvarrë
përdhe. Kështu nuk do të jesh as më kë-
mbë as kaluar.

Djali bëri si i tha plaku. Të parët e
vendit u çuditën dhe e pyetën:

— Kush të mësoi të bësh kështu?

— Më mësoi im atë, që është plak njeri.

Tani ata s'kishin ç'të bënin; e zgjo-
dhën gjykatës.

Një herë ndodhi një mot i keq dhe u
prish gjithë thekri që kishin mbjellë. Nuk
mbeti asnjë kokërr për farë. Të parët e
vendit vranë mendjen ç'të bëjnë e si të
bëjnë për të gjetur farë thekri, po nuk
ia dual në krye. Gjykatësi vajti e ia tre-
goi të gjitha babait:

— Baba, thekri u prish e nuk ka mbe-
tur asnjë kokërr për farë. Ç'të bëjmë?

— Bir i dashur, shko e hiq nga çatia një duaj thekërishte të vjetër, shpjere në arë dhe mbuloje me dhe. Kështu do të mbijë thekër për farë, se atje duhet të kenë mbetur mjaft kokrra të pashkundura.

Djali e dëgjoji përsëri babanë, mori një duaj thekërishte të mirë dhe e mbuloi me dhe. Pas ca kohe aty mbinë shumë kallinj thekri. Të parët e vendit u çuditën shumë dhe e pyetën:

— Kush të mësoi të bësh kështu?

— Më mësoi babai plak.

— Babai të paska mësuar shumë gjëra të mira, — i thanë ata. — Ku e ke babanë?

— E kam në shtëpi, nuk e kam vrarë. I jap të hajë e të pijë.

— Po përse e mban në shtëpi me të ngrënë e të pirë?

— E para nga të parat e mbaj se e kam baba dhe e dua që të rrojë sa më shumë; ai më ka falur jetën; e dyta e dua se ai më jep këshilla të mira.

Që atë ditë të parët e vendit vendosën të mos i vrasin pleqtë, po t'i lenë të rrojnë që t'u japin këshilla të rinjve.

Që atëhere njerëzit nuk i vrasin më pleqtë, po i lenë të rrojnë gjersa të vdesin vetiu, nga pleqëria.

Guri i vogël shumë i çmuar

Do t'ju tregoj përrallën e gurit të vogël shumë të çmuar të xhaxho Pavelit.

Xhaxho Paveli ishte bari. Ai kish ca krerë dhen që i mbante nëpër kullotat e maleve Ballkan. Ditën e kulloste, natën i mbyllte në vathë. Xhaxho Paveli kish një shtëpizë të mbuluar me tjegulla, një mace e një qen. Kaq. Mirëpo ai s'kish kandil për dritë, që ta ndizte kur errej e bëhej natë.

Një ditë, kur kulloste tufën e dhenve, xhaxho Paveli dëgjoi në një lëndinë një zë të hollë, shumë të hollë, si me të vajtuar, që kërkonte ndihmë. Xhaxho Paveli

hyri në pyll, hodhi sytë rreth e qark dhe pa se ca drurë kishin marrë zjarr e po digjeshin. Poshtë, në një kërcu, pa një hardhuc larush që përpëlitej e thërriste me zë të hollë me të qarë, se po i afrohej flaka e zjarrit. Hardhuci e pa plakun dhe iu lut:

— O vëlla bari, nxirrmë nga zjarri! Shpëtomë!

— Unë dua të të ndihmoj, — o hardhuc i vogël, i tha xhaxho Paveli, — po s'mund të hyj në zjarr, se më digjen këmbët.

— Zgjat atë kërrabën që ke në dorë, të kapem pas saj, pastaj hiqe dhe shpëtomë.

Ashtu bëri xhaxho Paveli: zgjati kërrabën që kish në dorë, hardhuci u kap mirë e mirë, si një dredhë, dhe kështu shpëtoi nga zjarri. Si shpëtoi, i tha plakut:

— Tani dua të ta shpërblej të mirën që më bëre. Eja pas meje.

— Si do të më shpërblesh ti mua? — i tha plaku. — Ti je një hardhuc i vogël.

— I vogël jam, — ia ktheu hardhuci, — po duhet të dish se unë jam biri i mbretit të hardhucëve. Im atë rron në një shpellë të madhe, shumë të madhe e të errët. Ai mban në kokë një kurorë. Kjo kurorë

ka nëntë gurë të çmuar që ndriçojnë si nëntë diej e bëjnë mrekullira. Ty do të të dhuroj një nga këta gurë për të mirën që më bëre.

Me të thënë këto fjalë, hardhuci vrapoi nëpër bar drejt lumit të vogël. Plaku e ndiqte. Shko-shko, arritën në një shpellë.

— Ti, xhaxho, rri e prit këtu, — i tha hardhuci, — se unë do të hyj brenda të të sjell gurin e çmuar.

Xhaxho Paveli u ul dhe ndenji në tokë. Nisi të erret pak nga pak. Gjersa doli hardhuci me gurin e çmuar ish errur fare e bërë natë. Dhe ja, sapo doli hardhuci me gurin e çmuar në gojë, gjithë lëndina rreth e qark u mbush me dritë, sikur të paskej shkrepur agimi. Zogjtë që ishin tullitur nëpër drurët, zunë të përpjekin krahët dhe të cicërojnë, pandehën se me të vërtetë po lindte dielli.

— Merre këtë gur të vogël, — i tha hardhuci bariut, — dhe shko në shtëpi. Kur të të teket të kërkosh gjësend, përplase gurin tri herë në tokë dhe thuaj: «Dua këtë e këtë!» Dhe guri do të të sjellë ç'të duash.

Xhaxho Paveli mori gurin e vogël të ndritur dhe e kqyri: guri nuk ishte më i madh se një lajthizë. E futi në trastë e u nis për në shtëpi. Arriti aty bashkë me tu-

fën e dhenve dhe pa se qeni e macja e prinin te pragu. Plaku mbylli dhentë në vathë, hyri në shtëpi dhe nxori nga trasta gurin e vogël. Ky llamburiti dhe ndriçoi gjithë shtëpizën. Qeni dhe macja zunë sytë me shputë, se ua verboi drita.

Xhaxho Paveli hëngri darkë e tha me vete:

— Ç't'i kërkoj këtij guri? Nuk do t'i kërkoj asgjë. Unë i kam të gjitha ato që më duhen: shtëpi, dhen, djathë. Më parë s'kisha kandil për dritë, tani kam dritë sa të dua, kështu që nuk ha darkën në errësirë.

Me të thënë këto fjalë, xhaxho Paveli ra të flerë. Ra, po nuk e zuri gjumi. Nisi të vrasë mendjen:

«Po sikur t'i kërkoj gjësend gurit? Do më japë apo jo? Ç't'i kërkoj? Eh, do t'i kërkoj një pallat të madh me mure guri të bardhë».

Plaku u ngrit nga shtrati, iu afrua raftit ku kish vënë gurin e ndritur, e mori në dorë, e përplasi tri herë në tokë e tha:

— Dua të kem një pallat me mure guri të bardhë!

Me të thënë këto fjalë, shtëpiza e vjetër lëvizi nga vendi dhe u zhduk s'di se ku. Në vend të saj u ngrit një pallat i bukur me mure guri të bardhë. Ky pallat ishte

brenda tërë pasqyra të ndritura. Enët ishin të arta, tryezat e fronat ishin të fildishtë.

Plaku u çudit shumë e hyri dhomë më dhomë, i shikoi të gjitha, i preku me dorë. Më në fund u shtri në një shtrat të butë me pupla, kurse gurin e çmuar e fshehu në gji.

Mirëpo ç'na ndodhi? Që atë mbrëmje xhaxho Pavelit i vajti fqinji i tij Ivani e i tha:

— Erdha të të shoh a je shëndoshë e mirë, se më kish marrë malli. Më thuaj, vëlla, kush ta ndërtoi këtë pallat? Çudi! E shikoj e s'më vjen t'u zë besë syve. Shumë i bukur qenka.

Këtë pallat ma ndërtoi guri im i vogël.

— Ç'është ky gur i vogël? Tregoma edhe mua se dua ta shoh.

Xhaxho Paveli futi dorën në gji, nxori gurin e vogël të çmuar e ia dha fqinjit në dorë. Ivani e shikoi e tha:

— Si është e mundur që një gur kaq i vogël të ndërtojë një pallat kaq të madh?

Xhaxho Paveli i tha se si i kish ndodhur puna me atë hardhucin e vogël dhe se si mund t'i kërkonte çdo gjë gurit të vogël. Ama në këtë kohë e kish futur gurin prapë në gji.

Folën sa folën, pastaj zunë të gogësijnë

të dy; u kish ardhur gjumi. Xhaxho Paveli i tha fqinjit:

— O Ivan, a nuk rri sonte të flesh këtu?

— Ku të fle?

— Ja, në këtë shtrat me pupla pranë meje.

Ivani nuk e zgjati, po u shtri përkrah xhaxho Pavelit dhe bëri sikur fjeti, priti gjersa ta zërë gjumi këtë. Prit-prit, më në fund xhaxho Paveli fjeti. Atëhere Ivani i futi dorën në gji, mori gurin e çmuar, e përpoqi tri herë për tokë e thirri:

— Të dalin përpara meje katër kreshnikë, ta ngrenë këtë pallat dhe ta shpien përtej Danubit.

Me të mbaruar këto fjalë, dualën katër kreshnikë të fortë, e ngritën pallatin dhe e shpunë përtej Danubit. Ivani shkoi pas tyre bashkë me gurin e çmuar, kurse xhaxho Paveli mbeti në vend, në gjumë. Të nesërmen hapi sytë, vështroi rreth e qark — dhe ç'pa? Pallati ishte zhdukur. Po ashtu edhe guri i çmuar që kish pasur në gji. Në vend të pallatit gjendej ajo shtëpiza e vjetër me pullaz tjegullash, dhe, brenda në shtëpizë, qeni e macja. Plaku qau me lot. Dhenve u erdhi shumë keq e zunë të blegërijnë. Qeni u bë pikë e vrer; macja miaulliti. Më në fund macja i tha qenit:

— Eja të shkojmë matanë Danubit që të kërkojmë gurin e ndritur të xhaxhos.

— Eja! — ia ktheu qeni.

Thanë e u nisën. Shko-shko, kaluan gjithë luginën e gjerë të Danubit dhe arritën buzë këtij lumi të madh e të qetë.

— Unë di të notoj, — tha qeni, — ti nuk di. Hip në shpinën time dhe unë do të të nxjerr në bregun tjetër.

Macja i hipi në shpinë qenit. Ky e nxori matanë Danubit. Ecën edhe ca gjersa arrinë në një pallat të bukur me mure guri të bardhë. Pritën në kopsht gjersa u err, pastaj hynë nëpër një dritare të hapur. E ç'pënë atje? Ivani, fqinji i xhaxho Pavelit, flinte në një shtrat me pupla. Gurin e çmuar e kish fshehur në gojë, nën gjuhë.

— Si t'ia nxjerrim gurin nga goja? — pyeti qeni.

— Prit të të them, — ia ktheu macja. — Unë do t'i afrohem ngadalë, do t'i fus bishtin në vrimën e hundës dhe do ta gudulis. Ivani do të teshtijë, guri i çmuar do t'i dalë nga goja e ne do ta marrim.

Macja bëri ashtu siç tha. Iu afrua ngadalë Ivanit, i futi majën e bishtit në hundë, e gudulisi. Ivani teshtiti me të madhe e atëherë guri i çmuar i doli nga goja e ra përdhe. Macja e rrëmbeu e iku me të katra. Qeni e ndoqi hap pas hapi. Ikën-ikën, gjer-

sa arritën në breg të Danubit. Aty macja i hipi qenit si më parë. Ky u fut në ujë e notoi. Arriti gjer në mes të lumit. Aty qëndroi e i tha maces:

— Ky gur qenka me të vërtetë i çuditshëm. Ma jep ta shoh.

— Tani s'mund të ta jap, — ia preu macja, — se do të të bjerë në ujë. Prit gjersa të dalim në breg e atje do të ta jap ta shikosh sa të duash.

— E dua tani, — ulëriu qeni. — Po të mos ma japësh, do të të hedh në ujë, do të të mbyt!

Macja u tremb e i tha:

— Na, merre!

Qeni zgjati shputën të marrë gurin, po nuk e kapi dot dhe guri ra në ujë. Ata të dy, qeni e macja, dualën në bregun tjetër e zunë të qajnë.

Shkoi aty pranë një peshkatar me një grep dhe i pyeti:

— Pse qani?

— Nga uria, — i tha macja.

Peshkatori hodhi grepin në ujë, nxori një peshk të madh dhe ua hodhi atyre të dyve, maces e qenit.

— Na, — tha, — hajeni e mos qani më!

Macja e qeni muarën peshkun e zunë

të hanë. Por ç'gjetën brenda në bark të peshkut?... Gurin e çmuar! Kur ata po kalonin Danubin, peshku gjendej poshtë, në ujë, me gojën të hapur. Guri i çmuar, që i shpëtoi nga shputa qenit, ra drejtpërdrejt në gojë të peshkut. Pastaj këtë peshk e zuri peshkatari.

Sa shumë u gëzuan macja e qeni! Ata kaptuan malet e pyjet këtej Danubit gjersa arritën atje ku kulloste dhentë xhaxho Paveli. Plaku ish shtrirë përdhe e qante. Macja e qeni iu afruan tinëz dhe i lëshuan gurin mbi krye. Guri llamburiti. Xhaxho Paveli u ngrit i gëzuar, mori gurin e çmuar, e përplasi tri herë përdhe e thirri:

— Të dalë këtu, përpara meje, ai Ivan — kusari i futur në një thes!

Me të thënë këto fjalë, përpara xhaxho Pavelit u gjend një thes. Brenda në thes ishte vetë Ivani, fqinji që i kish vjedhur gurin. Xhaxho Paveli mori shkopin dhe zuri ta rrahë. E rrahu sa e rrahu, pastaj zgjidhi thesin, e nxori Ivanin, i dha ca shqelma dhe e dëboi. Gurin e çmuar e futi në qese e tha:

— Tani nuk më duhet as pallat e asgjë tjetër, sepse sidoqoftë, Ivani, i paudhi, do të vijë të ma vjedhë. Unë e njoh ç'njeri është.

Dhe kështu xhaxho Paveli u kthye prapë te tufa e dhenve, që i jepte të gjitha të nevojshmet. Gurin e çmuar e vinte natën në raft që t'i ndriçonte shtëpinë. Kur vdiq plaku, erdhi vrap hardhuci i vogël dhe e mori gurin e çmuar.

Ethja dhe murtaja

Ethja dhe Murtaja ishin nisur e udhëtonin bashkë. Shko-shko, ja tek panë një bari që po kulloste bagëtinë. Ethja i tha Murtajës:

— Haj t'i marrim një dash.

S'ia merr dot! — ia ktheu Murtaja.

— Do t'ia marr! — tha Ethja dhe bëri përpara.

Ajo iu afrua bariut dhe i thirri:

— Zëre këtë dash e ma jep mua.

— Ta zë e të ta jap? Po kush je ti? — e pyeti bariu.

— Unë jam Ethja.

— Mirë, ty do të të jap një dash! — i tha bariu.

Mirëpo sa të mbyllësh e të hapësh sytë, Ethja iu hodh bariut, i hyri brenda në trup e zuri ta dredhë. Bariu zhveshi shpejt e shpejt rrobat, i hodhi për tokë edhe... bluf!.. brenda në lumë. Ethja u tremb, u përpëlit në ujë e mezi doli tutje, në anën tjetër. Ajo s'mundi ta mposhtë më barinë e t'i marrë dashin.

Atëherë i erdhi radha Murtajës, që tha:
— Unë do t'ia marr dashin.

Me të thënë kështu, Murtaja u hodh e zuri barinë.

— Kush je ti? — e pyeti bariu.

— Unë jam Murtaja, — iu përgjigj ajo.

— Mirë, — i tha bariu, — po dashi nuk ecën dot vetëm. Ai do shokë. Do të të jap dhjetë desh, po më parë dua të të pyes një fjalë: ti i merr të gjithë njerëzit përnjëherë?

— Jo, nuk i marr të gjithë përnjëherë,

— ia ktheu Murtaja. — Unë marr vetëm ata që janë shkruar në defterin tim.

— Po më thuaj: a e ke edhe emrin tim në defter? — e pyeti bariu.

— Jo, — i tha Murtaja. — Nuk kam në defter as emrin tënd e as emrin e ndonjërit nga shtëpia jote.

— Aha! — thirri bariu. — S'na paske në defterin tënd! Atëhere prit të të jap një dash të majmë.

Me të thënë kështu, ngriti shkopin edhe

i ra e tank e tunk Murtajës, sa që kjo s'diti si iku.

Kur u takuan përsëri, tutje, Ethja me Murtajën thanë:

— Të ikim sa më larg, se ky njeri pas-ka qenë i çmendur.

Dhe ikën e nuk u panë më andej.

Fiton mendja, jo fuqia

Një luan plak u nis e shkoi tek bishat e pyllit. Ecte dhe mburrej me të madhe, brruronte sa tundej dheu.

— S'ka e s'ka në botë më trim e më të fortë se unë! Jam mbret mbi të gjithë! — thosh luani plak.

Shko-shko, gjeti udhës një ari plak, të çalë: s'di se kur e kish goditur me sëpatë një bari. Ariu i tha:

— Mos u mburr kështu, o luan. Në botë ka një trim më të fortë se ti.

Luani u zemërua, kërceu përpjetë, zgërdheshi dhëmbët:

— Kush është më i fortë se unë? Folë!

— Njeriu, — u përgjigj ariu.

— Ku është njeriu? Dua ta shoh dhe të matemi se kush është më i fortë.

— Dil në fushë dhe do ta gjesh, — i tha ariu.

Luani doli vrap nga pylli dhe zuri të bredhë fushave për të kërkuar njeriun. Në një luginë pa një kalë që po kullostte. Këmbët i kish të lidhur me tërkuzë e mezi çapej, me të këcyer. Luani iu afrua dhe i thirri me të madhe:

— Cili je ti, o barngrënës?

— S'më sheh? Jam kali.

— Kush të ka lidhur kështu me tërkuzë?

— Njeriu.

— Ku është njeriu?

— Shkoi në mal për dru.

Luani u kthye dhe ia mori për në mal. Udhës pa dy qe të mbrehur në parmendë. Rrinin e çlodheshin. «Pa tjetër, tha luani, këta janë njerëz», dhe iu afrua.

— Hej, ç'jini ju që rrini të mbrehur në zgjedhë? — i pyeti ai.

— Ne jemi qe.

— Ç'bëni këtu?

— Gjer tani lëruam tokën. Tani po çlodhemi pak.

— Kush ju ka vënë në zgjedhë?

— Njeriu.

«Hë, ia bëri luani, njeriu qenka me të vërtetë i fortë!» dhe shkoi përpara. Hyri në pyll. Ec-ec, arriti në një lëndinë. Aty pa një qerre me dru. Përpara qerres rrinin dy buaj të mëdhenj, të zez.

— Ç'jini ju? — pyeti luani.

— Buaj, — iu përgjigjën ata.

— Ç'prisni këtu?

— Njeriun. Tani do të vijë, do të na mbrehë në zgjedhë që t'ia shpiem drutë në shtëpi.

— Po ai ç'do të bëjë?

— Do të hipë e do të rrijë në qerre. Ne do të heqim qerren, ai do t'i bjerë fyellit.

— Ku është njeriu?

— Ja andej, prapa atyre drurëve. Po gërmon një gropë të thellë që të bien brenda bishat e pyllit.

Luani u nis e shkoi te njeriu. Në këtë kohë ky kish mbaruar së gërmuari gropën dhe e kish mbuluar me degë plot fletë. Luani e pa dhe brruroi me të madhe prapa tij. Njeriu u tremb kur dëgjoi dhe u kthye të shohë. E pa luanin dhe i shkuan dridhma nëpër trup. Luan, ky! Ç'të bënte njeriu? Shikoi rreth e qark për të kërkuar ndihmë. Po s'kish kush ta ndihmonte. «E shoh, tha me vete, se këtë bishë të egër nuk e mund dot me fuqinë time. Këtu duhet të punoj me mendje».

— Pse ke ardhur tek unë? — e pyeti njeriu luanin.

— Dua të matemi bashkë e të shohim kush është më i fortë, ia ktheu luani. — Më kanë thënë se gjoja ti paske qenë më i forti nga të gjithë.

— Po si të matemi?

— Me luftë. Do të luftojmë bashkë e do të shohim se kush do të dalë më i fortë

— Mirë, — iu përgjigj njeriu. — Po më parë hajt të shohim kush do të kërcejë më shumë.

— Hajt të shohim, — ia ktheu Luani. — Fillo ti.

Njeriu mori hov, kërceu dhe arriti gjer buzë gropës që kishte gërmuar vetë. Vuri atje si shenjë një gur dhe u hoq mënjane.

— Tani e ke radhën ti, o luan.

Edhe luani mori hov, këceu shumë më larg se sa njeriu dhe ra brenda në gropë.

Njeriu qeshi dhe iu afrua gropës tek po përpëlitej mbreti i bishave të egra. Luani u mundua të dalë, po më kot; gropa ishte shumë e thellë. Njeriu mori sëpatën, e vrau luanin, ia ropi lëkurën, bëri opinga dhe rripa.

Kështu, me mendje, njeriu e mundi luanin.

Ç'të mbjellësh do të korrësh

Ishte një lypsar plak që bridhte derë më derë me një torbë krahut e kërkonte lëmoshë. Plaku thosh oreçast: «Ç'të mbjellësh, do të korrësh».

Një ditë sosi në një fshat e trokiti te dera e një kamësi. Doli e shoqja e kamësit, e pa lypсарin e i tha të priste pak, pastaj hyri prapë në shtëpi. Pas një copë here doli përsëri me një pite të ngrohtë në duar. Ia dha lypсарit e i tha:

— Bukë s'na u ndodh në shtëpi. Merre këtë pite e haje. Kur të vish një herë tjetër, do të të jap bukë.

Plaku mori piten, e futi në torbë, uroi

e shkoi më tej. Si lypi derë më derë, la fshatin e shkoi më tutje. Udhës gjeti ulur në një gur një djalosh që rënkonte e gulçonte. Djaloshi dukej shumë i lodhur. Lyp-sari e pyeti:

— Ç'ke që rënkon e gulçon, o djalosh?

Djaloshi i tha:

— Unë jam udhëtar e po vi nga një vend i largët. Më ka marrë uria e mezi mbahem më këmbë.

Plakut i erdhi keq për këtë djalosh. Nxori nga torba piten që i kish falur në fshat e shoqja e kamësit e ia dha.

— Merre e haje, o djalë i mirë, që të marrësh fuqi e të shkosh më tej.

Pastaj plaku shikoi udhën. Ne po e le-më lyp-sarin në punë të tij e po kthehemi të shohim se ç'bëri udhëtari.

Si hëngri një copë pite të butë dhe e mori pak veten, djaloshi u ngrit e shkoi në fshat. Bëri një copë udhë, ndenji prapë në një gur dhe hëngri copën tjetër të pites që i kish dhënë plaku. Shko-shko, nisi t'i brejë barku. Shtrëngoi dhëmbët, u ul poshtë, u ngrit përsëri e shkoi më tutje. Kështu arriti në fshat e shkoi në shtëpi të tij. Barku i dhimbte shumë e më shumë. Djaloshi zuri të përpëlitet.

— Oh, nëno, po vdes!

Nëna u trondit shumë dhe e pyeti se ç'kish ngrënë e ç'kish pirë.

— Më kishte marrë uria, nëno. Mezi çapësja. Udhës gjeta një lypsar plak që më dha një pite të ngrohtë. E hëngra.

Kur dëgjoji këto fjalë, nëna mend u çmend, zuri të shkulë leshrat. Ç'kishte ndodhur? E shoqja e kamësit i kishte dhënë lypsarit plak një pite të helmuar, që të mos i shkelte herë tjetër në derë.

Tani ne po e lemë të shoqen e kamësit të bëjë ç'të dojë që ta shpëtojë të birin, dhe do të kthehemi te lypsari plak...

Ky arriti në një fshat tjetër. Zuri të trokasë derë më derë, të zgjatë dorën për të kërkuar lëmoshë dhe të thotë oreçast siç e kish zakonin:

— Ç'të mbjellësh, do të korrësh. Mos i mih varrin tjetrit se do të biesh vetë brenda.

Bariu dhe ato tri nuset e ujit

Ishte një bari, djalë i ri sapo dirsur mustaqja. Ky kulloste dhentë në një livadh të gjelbër, buzë një lumi, në mes të një pylli. Një ditë prej ditësh dëgjoi një zhurmë, sikur u llokoçit uji. Hodhi sytë andej e pa tri vashëza shumë të bukura që po laheshin në lumë. Laheshin e qeshnin të gëzuara. Bariu s'ua hoqi dot sytë: kaq të bukura ishin të tria!» Oh, sikur të kisha qenë më pranë! — tha ai me mendje. — Do të zija njërën nga këto tri të bukura e do ta merrja nuse!»

Ato tri të bukurat u lanë e u shpëlanë, pastaj dualën në breg; veshën shpejt kë-

mishët që kishin lënë aty e nuk u panë më. Të nesërmen, para se të gdhihej ditë, bariu e ngau tufën në livadh, buzë lumit, dhe u fsheh në një gëmushë. Ndenji aty e priti të vinin ato tri të bukurat e të laheshin. Me të shkrepur dielli, vashëzat iu afruan lumit, xhveshën këmishët, hynë në ujë e zunë të laheshin, të qeshnin. Bariu i shikonte nga gëmusha ku ishte fshehur, po nuk guxonte t'u afrohej; druhej mos i trembte.

Ditën e tretë la dhentë në livadh e hyri u fsheh në një gëmushë tjetër, buzë lumit. Shkrepi dielli, erdhën ato të tria. Ishin të bukura si tre yje. U zhveshën shpejt e hynë në lumë. Bariu zuri të vrasë mendjen; ç'të bënte që të zinte të paktën njëren nga të tria? Vrau sa vrau mendjen, pastaj kuturisi: «Do t'ua marr — tha — këmishët që kanë lënë në anë të lumit!»

Të thënë, të bërë! Doli shpejt nga gëmusha, vrapoi, e ua mori këmishët. I dhanë fjalën se do t'i bënin një dhuratë të madhe. Bariu e mori vesh se ato e kishin pisk punën e u tha:

— Dhuratë nuk dua, po dua që të marr nuse njëren nga ju të tria! Po të mos doni, unë do të nder një zjarr e do t'i hedh këmishët të digjen. Të shohim atëherë si do të ktheheni në shtëpi... Dëgjuat?

— Dëgjuam, — i thanë ato, — po ti duhet të kuptosh se ne të tria jemi motra e kësheta uji. Po të martohesh me një nga ne, njerëzit do të tallen me ty, do të të thonë se je martuar me një këshetë, me një nuse uji!

— Le të thonë ç'të duan! — ua ktheu djali. — Unë jam bërë për t'u martuar e do të martohem me atë që dua. Nuk pyes botën! Haj, flisni, shpejt, se ndryshe do t'jua hedh këmishët në zjarr!

Ato të tria e kuptuan se djali e kish me gjithë mend.

— Mirë, — i thanë, — na thuaj cila nga ne të pëlqen e të qoftë falur. Vetëm na jep më shpejt këmishët, se e kemi shtëpinë larg.

— Unë dua të voglën! — tha djali.

Atëherë të dy të mëdhatë e muarën mënjanë e i thanë:

— Mbaj vesh e dëgjo, o djalë! Sapo që të bëhet motra jonë gruaja jote, mos ia jep këmishën se do të të ikë. Kjo është një këmishë e magjepsur . Tërë fuqia e një nuse uji është këmisha!

Djali dëgjoi dhe e nguli në mendje fjalën që i thanë ato të dyja. Ua dha këmishët dy të mëdhave. Së tretës nuk ia dha. Ato sapo i veshën nuk u panë më. Të tretën, të voglën, e shpuri në shtëpi, natën,

i preu e i qepi një fustan nusërie, bëri dasmë dhe e mori grua. Edhe shkoi jetë për kokën e jetës me nusen e ujit. Në tërë botën s'kish nuse më të bukur se sa e shoqja e bariut.

Koha shkoi shpejt, në gëzime, e u mbush moti. Si u mbush moti, një nga të afërmit bëri dasmën e djalit të tij dhe i ftoi ata të dy: barinë me të shoqen. Në këtë dasmë gjithë gratë e fshatit hynë në valle, vetëm nusja e bariut ndenji mënjanë. Atëhere të gjitha e ftuan të vinte e të zihej për dore, po ajo u tha:

— Unë s'di të hedh valle si ju të tjerat. Di vetëm ashtu siç hedhin valle nuset e ujit. Po që të hedh valle, duhet të vishem si nuse uji. I thoni tim shoqi të më japë vetëm një çast atë këmishën që më ka marrë e kini për të parë se si do të kërcej.

Të mos e zgjatim: gratë zunë t'i luten bariut t'ia jepte këmishën së shoqes. Ai s'desh, sepse nuk e kish harruar fjalën që i kishin thënë të dy kunatat në breg të lumit. Gratë ngulën këmbë: «Jepja, jepja!» Fundja, bariu s'kish ç'të bënte, se e kishin zënë ngushtë. Shkoi në shtëpi, nxori këmishën ku e kish fshehur dhe u kthye në dasmë. E shoqja hyri në një dhomë; mbylli derën, u vesh. Si u vesh, doli jashtë, hyri në valle e nisi të kërcejë si nuse uji. Të gjithë mbetën të

habitur. S'kishin parë kurrë nuse që të kërcente kaq bukur. Kështu, lojti e kërcëu gjersa pushoi kënga. Atëherë ajo iu afrua të shoqit, i dha dorën e i tha:

— Tani rri me shëndet, o im zot! Unë ika!

Si tha kështu, u ngrit në erë e fluturoi. I shoqi e ndoqi me të katra e i thirri:

— Grua, moj grua! Përse po ik e po më le? Më thuaj të paktën një fjalë: ku të të kërkoh që të shihemi edhe një herë?

— O im shoq, — ia ktheu gruaja, — në do të më shikosh edhe një herë, kërkomë në anë të dheut, në fshatin Kushkundalev.

Tha kështu e s'u pa më.

Bariu nuk vonoi e u nis për udhë të pyesë se ku ndodhet fshati Kushkundalev. Eci-eci, po kudo që pyeti, njerëzit nuk dinin gjë se ku gjendej ky fshat. Ngrinin supet edhe e shikonin të çuditur: «S'dimë, s'kemi dëgjuar kurrë!» Shkoi fshat më fshat e qytet më qytet, pastaj u ngjit nëpër male e nëpër vende të shkreta. Kështu, vend më vend, një herë gjeti një plak me shkop në dorë, që rrinte mbështetur te një lis njëqind vjeç. Sapo e pa, plaku e pyeti:

— Si ke mundur të vish në këtë hum-

bëtirë, o bir? Këtej nuk shkel njeri, këtej nuk këndon gjel!

Djali ia ktheu:

— Mua më ka sjellë e keqja, o gjysh. Të lutem e të falem, a di se ku ndodhet fshati Kushkundalev? A mos gjendet në këto male?

Plaku iu përgjigj:

— Tani po e dëgjoj për herë të parë këtë emër, o bir. Unë kam dyqind vjet që rroj në këto vise e s'ia kam ndjerë emrin. Po ti si e ke punën? Ç'kërkon në atë fshat?

Bariu ia rrëfeu të gjitha. Plaku u mendua sa u mendua e pastaj tha:

— Jo, bir. Po të them edhe një herë se këtij fshati nuk ia kam dëgjuar emrin. Po ti mos e prish zemrën, se je i ri. Shko përpara. Pas një muaji do të arrish në ca male të tjera, më të larta. Atje do të gjesh një plak tjetër. Ky plak është im vëlla. I thuaj falmeshëndet nga ana ime, se ai është më i madh, treqind vjeç, dhe është mbret mbi gjithë kafshët. Tregoja të gjitha e lutju që të të ndihmojë.

Djali shkoi më tej. Pas një muaji gjeti një plak që rrinte i menduar pranë një lumi. Djali iu afrua, i tha të fala nga i vëllai e pastaj ia tregoi të gjitha ç'i kishin ndodhur.

— Ti rri këtu, — i tha plaku. — Ja tani do t'i mbledh të gjitha kafshët e do t'i pyes. Ndofta ndonjë mund të dijë se ku gjendet Kushkundalevi.

Tha kështu dhe dërgoi lajmëtarë në të katër anët. Pas pak zunë të mblidhen të gjitha kafshët e mbretërisë së tij, qëndruan në këmbët e pasme e iu falën. Plaku u tha:

— Dëgjoni, ju luanë e ju arinj, ju dhelpra e ju ujç dhe gjithë ju kafshët e tjera të pyllit. Dua t'ju pyes gjësend. Ju bridhni shpesh rrotull fshatrave. Më thëni: a kini dëgjuar se ku ndodhet fshati Kushkundalev?

— Jo, baba mbret, — i thanë ata, — s'kemi dëgjuar kurrë.

Atëherë plaku iu kthye bariut:

— Shikon? Këtej s'ka një fshat të kë-tillë. Megjithatë mbahu, mos e prish zemrën. Shko më tej. Pas një muaji do të arrish në ca male të tjera e do të gjesh një plak tjetër, tim vëlla të madhin. Ai është mbreti i gjithë shpësëve. Shpësët fluturojnë kudo e mund ta dinë se ku ndodhet fshati që kërkon ti.

Bariu i la shëndenë e u nis për udhë. Pas një muaji arriti në një mal të lartë e gjeti atje plakun e tretë, mbretin e shpësëve. Iu fal e i tha falmeshëndet nga të dy pleqtë e tjerë, të vëllezërit. Pastaj i

rrëfeu se ç'i kish ndodhur e iu lut që ta ndihmonte. Plaku dërgoi lajmëtarë e thirri gjithë shpesët e mbretërisë së tij. Nuk shkoi shumë e këta u mblodhën përpara mbretit, iu falën e i thanë:

— Urdhër, mbret!

— Më thoni, o shpesë të mëdhenj e të vegjël, shqiponja e fajkoj, sorra e laraska e gjithë sa jini: a dini se ku ndodhet fshati Kushkundalev?

— Nuk dimë, o mbret. S'kemi dëgjuar kurrë, — iu përgjigjën shpesët.

— Po, po... — i tha plaku bariut, — Me që shpesët e mi që fluturojnë kudo nuk dinë, ndofta nuk ka në botë fshat të këtillë. As unë, që jam katërqind vjeç, s'kam dëgjuar kurrë.

Atë çast iu afrua mbretit një laraskë e çalë. Mbreti e pa dhe e pyeti:

— Po ti pse u vonove kaq shumë? Er-dhe e fundit. Pse shkele urdhërin tim?

— Unë jam e çalë, o mbret! — ia ktheu laraska uloke. — Veç kësaj, e kam çerdhen shumë larg. Vij nga fshati Kushkundalev, atje ku banojnë nuset e ujrave. Sapo dëgjova urdhërin tënd, u bëra gati të nisem, po duhet të dish se unë jam shërbëtore e një nuse uji. Ajo më theu këmbën. Mezi kam ardhur. Falmë, o mbret.

Plaku u kthye e i tha djalit:

— Dëgjove se ç'tha laraska? Tani hip mbi një shqiponjë e nisur. Laraska do të të rrëfejë udhën.

— Rrofsh e qofsh, o mbret! — i tha djali. — Këtë të mirë nuk do të ta harroj kurrë.

Plaku i tha shqiponjës më të madhe që kish në mbretërinë e tij që ta shpinte babinë në fshatin Kushkundalev. Laraska shkoi përpara, shqiponja me djalin prapa Fluturuan ditë e natë. Në mëngjes arritën në Kushkundalev. Shqiponja u ul, djali zbriti e shkoi të pyesë se ku rrinin tri motrat. Shtëpia ku hyri për të pyetur ndodhi e tyrja. Ato dy të mëdhatë e panë, e njohën e mbetën të mahnitura.

— Medet, medet! Sa shumë qenke lodhur, o kunat. Siç duket, ti e do shumë motrën tonë, se për të kaptove kaq male e kaq gryka. Ne do të të ndihmojmë.

Pastaj ato e pyetën ç'kish ndodhur e përse ia kish dhënë motrës së tyre atë këmishën e magjishme? Djali ua tregoi të gjitha, një për një dhe iu lut të kunatave që t'ia jepnin nusen.

— Mos u trondit, o djalë! — i thanë ato. — Jot shoqe është këtu, në shtëpi. Tani fle. Merr këtë shalë dhe eja pas nesh. Ne do ta lidhim në gjumë e do ta vemë në shalë. Ti do të rrish pranë saj. Shala do të

ngrihet lart e lart, mbi majat e maleve. Vetëm ki mendjen se sapo të zgjohet nga gjumi, motra jonë do ta thërresë kalin e saj. Përpiqu të arrish përpara se të zgjohet, matanë tre maleve. Po të arrish atje, do të shpëtosh; po të mos arrish, do të vijë kali e do të të bëjë copë-copë, se është shumë i fortë, i magjepsur.

Ashtu bënë. Bariu e të kunatat lidhën nusen pas shale, ai ndenji pranë saj dhe u nis. Shala fluturoi shpejt e shpejt, kapërcëu matanë tre maleve. Si kaloi tre malet, nusja u zgjua, kuptoi ç'kish ndodhur e nisi të ndjellë kalin. Kali e dëgjoi dhe fluturoi nëpër qiell, por në këtë kohë ata të dy kishin lënë prapa kufinë, kështu që kali s'kish më fuqi t'i ndiqte dhe u kthye nga kish ardhur.

Bariu arriti shëndoshë e mirë në fshatin e tij, ia zhveshi së shoqes këmishën e magjepsur e e hodhi në zjarr. Kështu, kjo s'ish më tani nuse uji. Ish grua si gjithë të tjerat. Po më e bukur nga të gjitha.

Pastaj ajo lindi vajza të bukura. Nga këto vajza të bukura rrjedhin të gjitha të bukurat e kësaj bote.

PËRMBAJTJA

Faqe

| | |
|---|-----|
| Parathënie | 3 |
| Përralla e Silianit që u bë lejlek | 13 |
| Vajza e llastuar | 32 |
| Të dymbëdhjetë muajt e vitit | 44 |
| Mbret Trojani me veshë cjapi | 48 |
| Farkëtari trim | 52 |
| Kështu u bë njeriu urith | 62 |
| Tri këshilla për tre florinj | 64 |
| Përse s'ka më vitore | 67 |
| Lauresha e mirë | 79 |
| Ariu, derri e dhelpira | 89 |
| Dyert e të mëdhenjve | 93 |
| Misuri i mrekullueshëm | 96 |
| Që kur kanë zënë njerëzit të mos i vrasin pleqtë | 111 |
| Guri i vogël shumë i çmuar | 115 |
| Ethja dhe Murtaja | 125 |
| Fiton mendja, jo fuqia | 128 |
| Ç'të mbjellësh do të korrësh | 132 |
| Bariu dhe ato tri nuset e ujit | 135 |

INDEX

Page

| | |
|-----|-----------------------------|
| 127 | Index des noms de lieux |
| 125 | Index des noms de personnes |
| 123 | Index des noms de choses |
| 121 | Index des noms de lieux |
| 119 | Index des noms de personnes |
| 117 | Index des noms de choses |
| 115 | Index des noms de lieux |
| 113 | Index des noms de personnes |
| 111 | Index des noms de choses |
| 109 | Index des noms de lieux |
| 107 | Index des noms de personnes |
| 105 | Index des noms de choses |
| 103 | Index des noms de lieux |
| 101 | Index des noms de personnes |
| 99 | Index des noms de choses |
| 97 | Index des noms de lieux |
| 95 | Index des noms de personnes |
| 93 | Index des noms de choses |
| 91 | Index des noms de lieux |
| 89 | Index des noms de personnes |
| 87 | Index des noms de choses |
| 85 | Index des noms de lieux |
| 83 | Index des noms de personnes |
| 81 | Index des noms de choses |
| 79 | Index des noms de lieux |
| 77 | Index des noms de personnes |
| 75 | Index des noms de choses |
| 73 | Index des noms de lieux |
| 71 | Index des noms de personnes |
| 69 | Index des noms de choses |
| 67 | Index des noms de lieux |
| 65 | Index des noms de personnes |
| 63 | Index des noms de choses |
| 61 | Index des noms de lieux |
| 59 | Index des noms de personnes |
| 57 | Index des noms de choses |
| 55 | Index des noms de lieux |
| 53 | Index des noms de personnes |
| 51 | Index des noms de choses |
| 49 | Index des noms de lieux |
| 47 | Index des noms de personnes |
| 45 | Index des noms de choses |
| 43 | Index des noms de lieux |
| 41 | Index des noms de personnes |
| 39 | Index des noms de choses |
| 37 | Index des noms de lieux |
| 35 | Index des noms de personnes |
| 33 | Index des noms de choses |
| 31 | Index des noms de lieux |
| 29 | Index des noms de personnes |
| 27 | Index des noms de choses |
| 25 | Index des noms de lieux |
| 23 | Index des noms de personnes |
| 21 | Index des noms de choses |
| 19 | Index des noms de lieux |
| 17 | Index des noms de personnes |
| 15 | Index des noms de choses |
| 13 | Index des noms de lieux |
| 11 | Index des noms de personnes |
| 9 | Index des noms de choses |

Përralla të zgjedhura. I zgjedhi dhe
i përktheu. Dh. Pasko. [Red. D.
Omari] T., «Naim Frashëri», 1988

148 f

(B.m.): 398.21(497)

(B.v.): 398.2(497)

P 61

Tirazhi 10000 kopje Format 49x78/10 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë 1988